USHTRIA

Viti i 68-të i botimit Nr. 22 (8223) | Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes | E premte, 6 qershor 2014

KONFERENCA E 8-TË E SHSHP TË BALLKANIT

Promovohet bashkëpunimi ushtarak dhe mirëkuptimi rajonal ballkanik

U zhvillua në Bosnje-Hercegovinë, takimi i shefave të SHP të vendeve të Ballkanit

faqe 5

KËRKESA

SHBA, asistencë ligjore kundër korrupsionit

faqe 3

FLET MINISTRJA KODHELI

"Departamenti Shtetit, mbështetje maksimale për reformat e Mbrojtjes"

faqe 4

STËRVITJA E PËRBASHKËT "JCET-2014"

Atasheu amerikan, vlerëson kontributin e FS shqiptare përkrah atyre amerikane në Afganistan

faqe 6

FORUMI

NATO në shek. 21-të: Kërcënime të reja dhe kërcënues të rinj

Ministrja Kodheli merr pjesë në forumin "To be Secure", në Budva të Malit të Zi

Faqe 4

Takimi i Ministrave të Mbrojtjes u përqendrua në Mbrojtjen Kolektive dhe në Samitin e Uells-it

Aleanca, zhvillohet në Bruksel Ministeriali i Mbrojtjes

U zhvillua në Bruksel më 3-4 qershor, Ministeriali i radhës i ministrave të Mbrojtjes së vendeve të NATO-s, ku ishte e pranishme edhe ministrja e Mbrojtjes së Republikës të Shqipërisë, znj. Mimi Kodheli

Faqe 2-3

FESTA E FËMIJËVE TË USHTARAKËVE

QKMB, aktivitet festiv me rastin e 1-Qershorit

Çdo fëmijë është më shumë se një engjëll, është diçka që i tejkalon kufijtë e humanes, që të lidh me një diçka që është shumë e rëndësishme, që është trashëgimia që kemi lënë nëpërmjet dashurisë që transmetojmë për të rritur fëmijët qytetarë të denjë të shoqërisë dhe kjo është gjëja që nuk duhet të na mungojë kurrë

faqe 8-9

BASHKËPUNIMI

KDS, vizitë nga "Akademia e Nënoficerit" të Turqisë

faqe 6

STANDARDET

ANO certifikon kursantët e "Kursit të Lartë të Nënoficerit"

faqe 6

ISAF

Eksperienca në ISAF, hap cilësor i modernizimit të personelit të FA

faqe 10

FORCA DETARE

Samiti i komandantëve të FD të Europës: E ardhmja vendoset nga deti

faqe 7

Takimi i Ministrave të Mbrojtjes u përqendrua në Mbrojtjen Kolektive dhe në Samitin e Uells-it

Aleanca, zhvillohet në Bruksel Ministeriali i Mbrojtjes

U zhvillua në Bruksel më 3-4 qershor, Ministeriali i radhës i ministrave të Mbrojtjes së vendeve të NATO-s, ku ishte e pranishme edhe ministrja e Mbrojtjes së Republikës të Shqipërisë, znj. Mimi Kodheli

Mbrojtja kolektive dhe përgatitjet për Samitin e Uellsit të NATO-s në shtator ishin çështjet kryesore të takimit dy-ditor së ministrave të Mbrojtjes i cili filloi të martën më datë 3 qershor. Ministrat gjithashtu u takuan me homologët e tyre të Ukrainës dhe Gjeorgjisë dhe diskutuan misionin e ISAF-it në Afganistan me kontribuuesit e ISAF-it dhe ministrin e mbrojtjes të Afganistanit.

Sesioni i parë i punës u fokusua në implikimet më të gjera dhe afat-gjata të veprimeve të paligjshme të Rusisë në Ukrainë në drejtim të mbrojtjes kolektive. Ministrat diskutuan çfarë duhet bërë në një kohë afat mesme dhe afat gjatë. Kjo përfshiu diskutime mbi rritjen e reagimit të Forcës Reaguese të NATO-s, dhe më shumë përqendrim në forcat speciale, mbrojtjen kibernetike dhe rritjen e stërvitjeve. Ministrat zhvilluan një sesion të Komisionit NATO-Ukrainë për të diskutuar mbi gjendjen e sigurisë në Ukrainë dhe prioritetet për bashkëpunimin e mbrojtjes midis NATO-s dhe Ukrainës. Kjo u pasua nga një seancë e dytë e punës të 28 Aleatëve për të diskutuar rreth përgatitjeve më të gjera për Samitin e Uells-it në aspektin e gatishmërisë, aftësive ushtarake dhe investimeve të mbrojtjes.

E mërkura filloi me një seancë të Komisionit NATO-Gjeorgji për të diskutuar gjendjen aktuale të reformave të mbrojtjes të Gjeorgjisë dhe planet për punë të mëtejshme. Kjo ishte gjithashtu një mundësi për të diskutuar implikimet më të gjera rajonale të krizës Rusi-Ukrainë.

Ministeriali përfundoi me një takim të kontribuuesve të ISAF-it dhe ministrit të mbrojtjes të Afganistanit. Ata vlerësuan gjendjen aktuale të sigurisë, statusin e planifikimit për misionin jo-luftarak të propozuar nga NATO për të trajnuar, këshilluar dhe ndihmuar forcat afgane nga fillimi i vitit të ardhshëm dhe progresin e kalimit të përgjegjësive të sigurisë tek forcat afgane të sigurisë. Ministrat gjithashtu shqyrtuan tranzicionin politik pas zgjedhjeve të 5 prillit, duke përfshirë dhe raundin e dytë në qershor.

Ministrat e Mbrojtjes së NATO-s diskutuan mbrojtjen kolektive dhe prioritetet e samitit

"Ministrat e Mbrojtjes së NATO-s shqyrtuan masat e mbrojtjes kolektive në prag të krizës Rusi-Ukrainë dhe diskutuan rreth përgatitjeve për samitin e NATO-s në Uells. Ne po përballemi me një peizazh të ri të sigurisë, për shkak të agresionit në Ukrainë. Ne kemi ndërmarrë tashmë hapa të menjëhershëm. Në një shfaqje të fortë solidariteti, çdo aleat i vetëm, nga të dy anët e Atlantikut, kontribuon në forcimin e mbrojtjes tonë kolektive, duke përfshirë vendosjen e anijeve, avionëve dhe trupave. Me të vërtetë që është të gjithë për një dhe një për të gjithë", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Anders Fogh Rasmussen, në fillim të ministerialit dy-ditor, më 3 qershor.

Në seancën e parë të punës, ministrat shqyrtuan masat për të rritur mbrojtjen kolektive që u morën menjëherë pasi filloi kriza Rusi-Ukrainë dhe implikimet afatgjata së agresionit të Rusisë ndaj Ukrainës. Sekretari i Përgjithshëm tha se kriza e Ukrainës ka treguar se gama e kërcënimeve së sigurisë me të cilat përballet NATO po rritet e po bëhet më e paparashikueshme. "Ne duhet ta bëjmë NATO-n më të shpejtë e më fleksibël. Ne do ta bëjmë këtë nëpërmjet një Plani Veprimi Gatishmërie, për t'u siguruar se forcat tona janë edhe më të përgjegjshme, me aftësitë e duhura, trajnimin e duhur dhe burimet e duhura. Kjo punë tashmë është në vazhdim e sipër, por kriza e bën këtë më urgjente", tha Rasmussen.

28 aleatët diskutuan përgatitjet e mëdha për samitin e Uellsit në aspektin e gatishmërisë, aftësive ushtarake dhe investimeve të mbrojtjes. Ata zhvilluan gjithashtu në seancë të Komisionit NATO-Ukrainë, për të diskutuar rreth gjendjes së sigurisë në Ukrainë dhe prioritetet e bashkëpunimit të mbrojtjes ndërmjet NATO-s dhe Ukrainës në dritën e krizës dhe pas zgjedhjeve historike presidenciale.

Të 28 aleatët diskutuan gjithashtu përgatitjet e mëdha për samitin e Uellsit në aspektin e gatishmërisë, aftësive ushtarake dhe investimeve të mbrojtjes. Ata zhvilluan gjithashtu në seancë të Komisionit NATO-Ukrainë, për të diskutuar rreth gjendjes së sigurisë në Ukrainë dhe prioritetet e bashkëpunimit të mbrojtjes ndërmjet NATO-s dhe Ukrainës në dritën e krizës dhe pas zgjedhjeve historike presidenciale. Gjatë ditës së dytë të ministerialit, Komisioni NATO-Gjeorgji, shqyrtoi statusin e tanishëm së reformave të mbrojtjes së Gjeorgjisë dhe planet për punë të mëtejshme. Ministrat e Mbrojtjes diskutuan edhe implikimet më të gjëra rajonale të kësaj krize. Ministeriali përfundoi me një takim të kombeve që kontribuojnë me trupa në ISAF dhe ministrin e Mbrojtjes afgane. Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Europian për Çështjet e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë, Catherine Ashton dhe Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm së Kombeve të Bashkuara për Afganistanin, Jan Kubis, ishin gjithashtu të ftuar. Ata vlerësuan situatën aktuale të sigurisë progresin në kalimin e përgjegjësisë së sigurisë tek forcat e sigurisë afgane dhe planifikimin e për misionin e ri të jo-luftues të NATO-s për trajnimin, këshillimin dhe ndihmën e forcave afgane pas vitit 2014. Gjithashtu, ministrat rishikuan edhe tranzicionin politik pas zgjedhjeve së 5 prillit, duke përfshirë edhe një këndvështrim së raundit të dytë në qershor.

NATO rrit mbrojtjen kolektive dhe mbështet reformat në Ukrainë

Ministrat e Mbrojtjes së NATO-s ranë dakord më 3 qershor që të vazhdojnë dhe të përforcojnë më tej masat e sigurisë së NATO-s në prag të krizës Rusi-Ukrainë. "Kjo është koha që të gjithë aleatët të luajnë një pjesë dhe të gjithë ata po e bëjnë këtë. Çdo aleat po krijon resurse për mbrojtjen tonë kolektive dhe kur ne themi mbrojtja e NATO-s është "të gjithë për një", e kemi me të vërtetë", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s.

Rasmussen përshëndeti fuqishëm deklaratën e Shteteve të Bashkuara për t'i besuar 1 bilionë dollarë Iniciativës së Sigurisë Europiane si një "shenjë e qartë e angazhimit të Amerikës në Europë dhe forcës së lidhjes transatlantike".

Përsa i përket rrugës së Gjeorgjisë për anëtarësimin në NATO, Rasmussen përshëndeti progresin e bërë në reformat, duke thënë se këto i kanë bërë sektorët e mbrojtjes dhe të sigurisë më transparentë dhe të përgjegjshëm. "Ne presim zbatimin e mëtejshëm të reformave dhe do të vazhdojmë t'ju ndihmojmë në këtë proces", tha ai.

Gjithashtu, Sekretari i Përgjithshëm lavdëroi synimin e Polonisë për të rritur shpenzimet e saj të mbrojtjes me 2% të Prodhimit së Brendshëm Bruto.

Ministrat ranë dakord për të rritur aftësinë, trajnimin dhe gatishmërinë e forcave aleate për t'u përgatitur me implikimet afatgjata të krizës. Një Plan Veprimi Gatishmërie, që do të zhvillohet në samitin e Uellsit, do të përfshijë masa që kanë për qëllim rritjen e nivelit të përgjegjësisë, inteligjencës e vetëdijes së Forcave të Reagimit të NATO-s, për të para-pozicionuar pajisjet dhe furnizimet si dhe për t'i përqendruar stërvitjet e NATO-s akoma më shumë në sfidat specifike të mbrojtjes.

Ministrat miratuan nismën e Gjermanisë në "Kombet Strukturore", e cila do të ndihmojë nxitjen e bashkëpunimit shumëkombësh për të zhvilluar forcat dhe aftësitë e nevojshme në përmbushjen e kërkesave të NATO-s dhe përballimin e sfidave së reja të sigurisë. Sekretari i Përgjithshëm mirëpriti vendimin e Danimarkës, Gjermanisë dhe Polonisë për të filluar punën në rritjen e gatishmërisë së Trupave Shumëkombësh Verilindorë në Poloni. "Kjo do të forcojë aftësinë tonë për të adresuar kërcënimet dhe sfidat e ardhshme në rajon dhe ky është një kontribut i rëndësishëm në mbrojtjen tonë kolektive", tha ai.

Më tej, ministrat ranë dakord për një politikë të re së mbrojtjes kibernetike, duke e njohur kibernetikën si pjesë të mbrojtjes kolektive të NATO-s. Kjo politikë do të ndihmojë rritjen e shkëmbimit të informacionit dhe ndihmës së ndërsjellë midis aleatëve, duke përmirësuar stërvitjet dhe trajnimet e mbrojtjes kibernetike të NATO-s si dhe rritjen e bashkëpunimit me industrinë.

Gjithashtu, ministrat e Mbrojtjes së NATO-s u takuan me homologun e tyre ukrainas, Mykhailo Koval, në Komisionin NATO-Ukrainë. Ata përshëndetën rezultatin e qartë së zgjedhjeve të fundit presidenciale dhe riafirmuan mbështetjen e tyre ndaj reformave së mbrojtjes dhe sigurisë të Ukrainës. Një paketë e plotë masash që ka për qëllim rritjen e kapacitetit dhe fuqisë së Forcave të Armatosura Ukrainase do të finalizohet gjatë javëve të ardhshme.

Komisioni NATO-Gjeorgji diskutoi krizën e Ukrainës dhe progresin e Gjeorgjisë në reforma

Ministrat e Mbrojtjes së NATO-s u takuan me homologun e tyre gjeorgjian, Irakli Alasania, më 4 qershor, për të diskutuar ndikimet rajonale të agresionit së paligjshëm të Rusisë kundër Ukrainës dhe për të rishikuar progresin e Gjeorgjisë në reformimin e sektorit të saj të mbrojtjes. "Aleatët e NATO-s nuk e njohin e nuk do ta njohin aneksimin

STAFI

Kryeredaktor: Albert **HITOALIAJ**

Gazetarë: Mimoza **GOLIKJA**, Alba **MUSARAJ**

Redaktore korrektore: Elona **SHIMAJ MAKO**

Graphic Designer: Afërdita **HYSAJ**

ADRESA: **Ministria e Mbrojtjes, Rruga e Dibrës**

e paligjshëm të Krimesë nga ana e Rusisë. Gjithashtu, ne nuk e pranojmë njohjen e rajoneve të Osetisë Jugore dhe Abkhazisë së Ukrainës nga ana e Rusisë. NATO ngrihet për të drejtën e çdo kombi për të bërë zgjedhjen e vet sovrane në politikat e jashtme dhe ato të sigurisë", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s.

Përsa i përket rrugës së Gjeorgjisë për anëtarësimin në NATO, Rasmussen përshëndeti progresin e bërë në reformat, duke thënë se këto i kanë bërë sektorët e mbrojtjes dhe të sigurisë më transparentë dhe të përgjegjshëm. "Ne presim zbatimin e mëtejshëm të reformave dhe do të vazhdojmë t'ju ndihmojmë në këtë proces", tha ai.

Gjeorgjia është një nga vendet që nuk janë pjesë e NATO-s, por që jep kontributet më të mëdha në misionin e ISAF-it në Afganistan dhe Sekretari i Përgjithshëm përgëzoi Gjeorgjinë për rolin e saj të shquar në operacionet e NATO-s. Gjithashtu, Gjeorgjia është angazhuar të kontribuojë në misionin e ri të udhëhequr nga NATO për të trajnuar, këshilluar e ndihmuar forcat afgane pas vitit 2014 si dhe është ofruar të kontribuojë në Forcën e Reagimit të NATO-s në vitin 2015.

"Më lejoni të bëj të qartë se ne i qëndrojmë vendimit që kemi marrë në samitin tonë të Bukureshtit në vitin 2008. Gjeorgjia do të bëhet anëtare e NATO-s, me kusht që të plotësojë kërkesat e anëtarësimit. Ministrat e Jashtëm të Aleancës do të diskutojnë aspiratat e Gjeorgjisë në takimin e mëvonshëm gjatë këtij muaji. Unë jam i bindur se samiti ynë i Uellsit, i cili do të zhvillohet në muajin shtator do të njohë përparimin e Gjeorgjisë", tha Rasmussen.

Ministrat e Mbrojtjes diskutuan misionin e ISAF-it 2014 dhe përgatitjet e zgjedhjeve

Ministrat e Mbrojtjes së NATO-s dhe homologët e tyre nga vendet partnere të ISAF-it u takuan më 4 qershor me ministrin e Mbrojtjes afgane, Bismullah Khan Mohammadi, për të shqyrtuar përparimin në misionin e ISAF-it dhe përgatitjet për raundin e dytë të zgjedhjeve presidenciale afgane. "Forcat e Sigurisë Afgane bënë një punë

"Ministrat e Mbrojtjes së NATO-s shqyrtuan masat e mbrojtjes kolektive në prag të krizës Rusi-Ukrainë dhe diskutuan rreth përgatitjeve për samitin e NATO-s në Uells. Ne po përballemi me një peizazh të ri të sigurisë, për shkak të agresionit në Ukrainë. Ne kemi ndërmarrë tashmë hapa të menjëhershëm".

të shquar në sigurimin e raundit së parë të zgjedhjeve presidenciale, të cilat u zhvilluan në muajin prill. Populli afgane tregoi guxim të madh me pjesëmarrjen e madhe në votime. Çdo votë e hedhur ishte një fitore për demokracinë dhe për Afganistanin", tha Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s pas takimit.

Ministrat shqyrtuan tranzicionin politik pas zgjedhjeve të 5-prillit dhe diskutuan rreth raundit të dytë që do të mbahet më 14 qershor. "Ministër Mohammadi na ka siguruar se përgatitjet për raundin e dytë të zgjedhjeve janë në rrugën e duhur dhe se afganët janë të vendosur për të ndërtuar mbi arritjet e tyre", u shpreh Rasmussen. Ai vazhdoi duke thënë se, është me rëndësi që raundi i dytë të kryhet në mënyrë transparente dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Gjithashtu, ministrat vlerësuan gjendjen aktuale të sigurisë si dhe progresin në kalimin e përgjegjësisë së sigurisë tek forcat afgane. Rasmussen bëri të qartë se NATO ka bërë realitet premtimet e bëra në samitet e NATO-s në Lisbonë (2010) dhe Çikago (2012). "Siç kemi premtuar, ne kemi ndërtuar një forcë të aftë afgane prej 350.000 ushtarësh e policësh, të cilët janë të gatshëm të marrin përgjegjësinë e plotë për sigurinë e vendit të tyre. Siç premtuam, po planifikojmë gjithashtu një mision për të trajnuar, këshilluar e ndihmuar forcat afgane përtej fundit të këtij viti".

Sekretari i Përgjithshëm mirëpriti njoftimin e fundit të presidentit së SHBA-së, Obama, për kontributin e rëndësishëm që Shtetet e Bashkuara kanë për qëllim të japin lidhur me këtë mision. "Kjo është në përputhje me planifikimin tonë. Së bashku me kontributet e ofruara nga aleatët e tjerë dhe partnerët, kjo tregon angazhimin e vazhdueshëm të NATO-s në Afganistan", tha ai. Megjithatë, që NATO të vendosë misionin e trajnimit pas vitit 2014, duhet të nënshkruhen marrëveshjet e kërkuara të sigurisë dhe duhet të vihet në vend korniza e nevojshme ligjore. "Kjo është arsyeja pse unë e mirëpres faktin që të dy kandidatët në zgjedhjet presidenciale kanë treguar mbështetjen e tyre për nënshkrimin e marrëveshjeve të nevojshme, duke i cilësuar ato si një prioritet. Është në interesin e të gjithëve

KËRKESA

SHBA, asistencë ligjore kundër korrupsionit

Gjatë vizitës së saj në Bruksel, në Ministerialin e Mbrojtjes së ministrave të Mbrojtjes së vendeve të NATO-s, ministrja e Mbrojtjes shqiptare, znj. Kodheli, zhvilloi një takim kokë me kokë, më 3 qershor, me zëvendësasistenten e sekretarit të Mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për Rusinë, Ukrainën dhe Euroazinë, znj. Evelyn N. Farkas. Gjatë këtij takimi, znj. Kodheli e njohu znj. Farkas me reformat aktuale në fushën e mbrojtjes dhe në Forcat e Armatosura, siç janë propozimet e fundit për përmirësimin e kuadrit ligjor. Në këtë pikë, ajo u ndal gjithashtu edhe tek angazhimi i Ministrisë së Mbrojtjes në luftën kundër korrupsionit dhe në ristrukturimin e Forcave të Armatosura.

Të dy zyrtaret e larta, u ndalën tek çështje të rëndësishme të bashkëpunimit dypalësh dhe mundësinë e thellimit të mëtejshëm të tyre. Në këtë pikë, u diskutua veçanërisht kërkesa për asistencë ligjore e bërë nga ministrja Kodheli për çështje që kanë të bëjnë me luftën kundër korrupsionit. Znj. Kodheli dhe znj. Farkas diskutuan për situatën aktuale në Ukrainë, që ishte edhe tema kryesore e këtij ministeriali dhe masat që NATO po ndërmerr për të siguruar aleatët. Zëvendësasistentja e sekretarit amerikan të Mbrojtjes, Farkas, theksoi se SHBA-ja mbështet qeverinë shqiptare dhe Ministrinë e Mbrojtjes në reformat që ka ndërmarrë si dhe në angazhimet e saj në kuadër të NATO-s, duke i vlerësuar ato tejet pozitive.

Burimi: mod. gov. al

të ndërtojmë mbi ato që kemi arritur", tha Rasmussen.

NATO është e angazhuar për të mbështetur forcat afgane dhe aktualisht po vendos mekanizma për financimin e tyre pas vitit 2014. Gjithashtu, NATO është e angazhuar në partneritetin e saj afatgjatë me Afganistanin, i cili do të përfshijë dhe konsultime politike e bashkëpunim praktik. Ambasadori Ian Kubis, Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm së Kombeve të Bashkuara dhe një përfaqësues i Shërbimit së Veprimit të Jashtëm Europian, morën gjithashtu pjesë në këtë takim.

Ministrat e Mbrojtjes së NATO-s vendosën të zgjasin misionin e NATO-s kundër piraterisë deri në vitin 2016

Ministrat e Mbrojtjes së NATO-s vendosën të zgjerojnë operacionin e NATO-s kundër piraterisë, "Ocean Shield" (Mburoja Oqeanike), deri në fund të vitit 2016. Që nga gushti i vitit 2009, anijet e NATO-s kanë patrulluar ujërat e Bririt të Afrikës si pjesë e operacionit "Ocean Shield". Misioni i tyre është të kontribuojë në përpjekjet ndërkombëtare kundër piraterisë detare si dhe për të ndihmuar në ndërtimin e kapaciteteve së flotave rajonale. Operacioni "Ocean Shield", punon ngushtë me Forcat e tjera Detare që patrullojnë Oqeanin Indian, duke përfshirë edhe Forcat Detare të udhëhequra nga SHBA-ja dhe Forcat Detare të BE-së. Si pjesë e përpjekjeve të gjera ndërkombëtare, "Ocean Shield" ka ndihmuar për të reduktuar ndjeshëm aktivitetin pirat në rajon. Në vitin 2011, piratët kapën 24 anije dhe NATO regjistroi 129 sulme pirate nga Somalia. Në vitin 2012, numri i sulmeve ra në 20. Asnjë anije e vetme nuk u kap nga Somalia që nga maji i vitit 2012 dhe nuk ka anije tregtare që aktualisht mbahen nga piratët somalezë. Pavarësisht sukseseve, pirateria mbetet një kërcënim. Piratët ende vazhdojnë të posedojnë qëllimin dhe kapacitetin për të sulmuar anijet. Anijet e NATO-s vazhdojnë të zbulojnë përpjekjet e piratëve për të kapur anijet. Përveç kësaj, rrënjët e piraterisë vazhdojnë të mbeten brenda Somalisë.

"Ocean Shield" ndihmon në mbrojtjen e një prej korsive më të ngarkuara në botë të anijeve. Rreth 90% e të gjithë tregtisë globale kryhet nga deti dhe rreth gjysma e saj kalon nëpër Oqeanin Indian. Në vitin 2013, Banka Botërore vlerësoi se pirateria i kushton ekonomisë botërore 18 bilionë dollarë në vit. Përpjekjet e NATO-s kundër piraterisë ndihmojnë në uljen e kësaj kostoje.

Anije nga Spanja, Italia dhe Turqia janë aktualisht pjesë e flotës së NATO-s, e cila vepron afërsisht nga Gjiri Arab drejt Veriut, Seychelles drejt Jugut, Gjiri i Adenit drejt Perëndimit dhe Maldives në Lindje, duke mbuluar një sipërfaqe më të madhe se 2 milionë kilometra katrorë ose madhësinë e Europës Perëndimore. Anijet e NATO-s verifikojnë aktivitetin e anijeve somaleze, duke ndarë trafikun legjitim detar nga anijet e dyshuara pirate. Anijet komerciale që po kalojnë përmes zonës në shumë raste shoqërohen për të garantuar kalimin e tyre të sigurt. Anijet e NATO-s mund të ndjekin në mënyrë aktive anijet e dyshuara si pirate për të parandaluar sulmet. Ekipet e bordit të NATO-s mund të hipin në anijet e dyshimta për të përcaktuar nëse piratët janë në bord. Si përpjekje të fundit, anijet e NATO-s mund të përdorin forcën për të ndaluar piratët. Çdo pirat i arrestuar transferohet sa më shpejt të jetë e mundur tek agjencitë kombëtare së zbatimit të ligjit.

Alba Musaraj,
burimi: NATO.int

"Departamenti Shtetit, mbështetje maksimale për reformat e Mbrojtjes"

E pyetur në ditën e festës së 1 qershorit, Ministrja Kodheli duke mos harruar të urojë para së gjithash fëmijët kudo që janë, jep detaje për mediat, në lidhje mbi takimin me Drejtorin e Departamentit të Shtetit për Evropën Qendrore dhe Juglindore, z. Jonathan Moore.

Keni pasur një takim me Drejtorin e Departamentit të Shtetit për Evropën Qendrore dhe Juglindore, z. Jonathan Moore. Cilat ishin disa nga çështjet e diskutuara dhe mesazhet e shkëmbyera?

Nëse me lejohet do tu uroja gjithë fëmijëve shqiptarë kudo që janë festën e 1 qershorit. Dhe meqë jemi tek fëmijët unë dua të siguroj qytetarët shqiptarë, që e ardhmja e fëmijëve të tyre është në dorën e tyre po aq sa është dhe në dorën e qeverisë që drejton këtë vend dhe qeverisja më e mire, do të sillte një të ardhme më të mirë. Por qeverisja më e mirë vjen sepse reforma më të mira bëhen, sepse ndërtohet shteti i së drejtës, sepse ka më shumë punë, ka më shumë begati. Dhe që reformat të bëhen, duhet pa dyshim të kemi një bazë të shëndetshme, të mirë ligjore mbi të cilën gjithë reformat mbështeten, ashtu siç kemi detyrimin politik, energjinë dhe vullnetin e mirë politik për t'i bërë këto reforma dhe pikërisht, meqë jemi tek reformat ndava me drejtorin Moore shqetësimet dhe problematikat që janë bërë publike pa dyshim dhe gjatë kësaj periudhë por dhe atë çka ne do të bëjmë në të ardhmen. Është shumë e rëndësishme që publikut t'i transmetoj realisht atë që fola me drejtorin Moore sidomos lidhur me mbështetjen që Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Departamenti Shtetit i japin Qeverisë shqiptare, ministrisë së Mbrojtjes për gjithë reformat dhe për gjithë procesin e reformave në cilin kemi hyrë. Ndryshimet ligjore me pak fjalë që unë u mundova t'ia shpjegoj dhe me të cilat absolutisht Departamenti i Shtetit, Departamenti i Mbrojtjes japin mbështetjen e tyre më të madhe. Përveç kësaj folëm edhe për shqetësimet që vijnë edhe nga sjellja e opozitës në këtë periudhë, ku nga ana e drejtorit Moore u theksua fakti që ky proces, procesi i marrjes së statusit kandidat për Shqipërinë është një nga proceset më të rëndësishme për Shqipërinë dhe shqiptarët dhe për të ardhmen e Shqipërisë, proces të cilin e drejton qeveria shqiptare nëpërmjet gjithçkaje që ka mbërritur nëpërmjet këtyre pak muajve qeverisje. Unë jam besimplotë, ata janë besim plotë se qeveria shqiptare, shqiptarët, do ta marrin këtë status dhe duhet që në këtë proces jo vetëm Shqipëria, por edhe opozita të mund ta ndihmojë këtë proces kaq të rëndësishëm për të gjithë ne. Jo siç opozita po vepron, krejt në pengesë krejt destruktive dhe në fakt, Xhonathan Moore ishte shumë preciz në gjënë që tha. Ne kemi folur me opozitën, ne kemi folur me qeverinë, ne kemi folur me Shqipërinë dhe shqiptarët ato që ne duhet të dëgjojë edhe veshi i opozitës përndryshe Shqipëria do të vazhdojë të mbetet në ngërçin e një lufte politike që nuk ka sens, që nuk ka në fokus mirëqeverisjen e vendit dhe pa dyshim dhe bërjen opozitë në një vend demokratik siç pretendojmë që jemi.

Në parlament po shqyrtohet në fakt paketa prej tre ligjesh, a ishte pjesë e bisedës me zotin Moore pretendimet e Presidentit të Republikës se Qeveria po i merr kompetencat?

Ishte pjesë e bisedës sepse unë desha që t'ia bëja prezent Drejtorit të Departamentit të Shtetit për Evropën Qendrore dhe Juglindore pikërisht këtë gjë. E sigurova që presidentit nuk i hiqet dhe nuk i preket asnjë kompetencë kushtetuese, por sigurisht një ligj i cili daton prej më shumë se prej dhjetë vjetësh, ka nevojë për rregullime ka nevojë për një "update"-im dhe kjo është gjëja që po bëjmë me bazën ligjore të cilën javën tjetër do ta kemi në parlament për rishqyrtim.

Kemi një zhvillim të ri në fakt, dje ka mbyllur punimet komisioni hetimor dhe kanë dalë në dritë faktet të reja që Gjadri është përdorur në kohën e qeverisjes së PD për trafik droge.

Unë besoj që kjo është një çështje që i takon prokurorisë, i takon institucioneve investiguese që të merren me këtë gjë. Ajo që unë vazhdoj të them dhe që kam thënë më përpara është, që nga momenti që Qeveria Rama ka marrë drejtimin e vendit, ne jemi totalisht të fokusuar drejt pastrimit të institucioneve që në fakt duhet të jenë të paprekshme, siç është institucioni, - po e quaj Institucioni Forcat e Armatosura, - të pastrimit të këtij institucioni nga gjithçka që ishte korruptive nga gjithçka që ishte antiligjore, antikushtetuese. Këtë jemi munduar të bëjmë dhe këtë do të bëjmë deri në fund. I siguroj qytetarët shqiptarë që Forcat e Armatosura nuk janë pjesë e asnjë pretendimi absurd keqdashës dhe provokativ të disa elementëve të opozitës shqiptare se Forcat e Armatosura, bazat e saj, apo mjetet e saj, strukturat e saj, janë pjesë e trafiqeve. Vazhdoj t'i mbetem këtij besimi. Gjithë historia tjetër i takon një periudhe që s'ka të bëjë me qeverisjen time si ministër i Mbrojtjes dhe pa dyshim i takon strukturave të Prokurorisë, gjykatave, të investigojnë lidhur me çfarë ka ndodhur përpara.

NATO në shek. 21: Kërcënime të reja dhe kërcënues të rinj

Ministrja Kodheli merr pjesë në forumin "To be Secure", në Budva të Malit të Zi

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli ka marrë pjesë në Forumin e katërt të quajtur "2BS (To Be Secure)" që do të thotë "Të qenit të sigurt", nën moton: "NATO në shekullin e 21-të: Kërcënime të reja dhe kërcënues të rinj". Ky takim u zhvillua në Budva të Malit të Zi, nga data 29 deri më 31 maj 2014. Në këtë takim morën pjesë ministra të Mbrojtjes, ambasadorë dhe përfaqësues të lartë të vendeve të rajonit dhe më gjerë. Në forumin "To be Secure" është diskutuar për një sërë çështjesh të rëndësishme, si për situatën në Ukrainë, për qëndrimin në Afganistan pas vitit 2014, etj. Duke marrë fjalën në këtë takim, ministrja Kodheli është ndalur në çështjen e Afganistanit pas 2014, duke theksuar: "Shqipëria do të jetë krah për krah me aleatët për vendimet që do të merren. Ne kemi bërë gjënë e duhur në kohën e duhur". Ministrja Kodheli zhvilloi gjithashtu një takim me ministren e Mbrojtjes së Malit të Zi, znj. Milica Pejanovic. Ministrja Kodheli i ka shprehur homologes së saj, znj. Pejanovic, se Shqipëria mbështet politikën e "dyerve të hapura" dhe dëshiron të shohë

Malin e Zi sa më shpejt anëtar të NATO-s. "Anëtarësimi i Mali i Zi në NATO do të thotë më shumë siguri dhe stabilitet në rajonin e Ballkanit", ka theksuar ministrja Kodheli. Më tej, ministrja Kodheli është shprehur se, shqiptarët e Malit të Zi janë dhe do të vazhdojnë të jenë një urë lidhëse mes dy vendeve tona dhe një element stabiliteti dhe bashkëpunimi mes Shqipërisë dhe Malit të Zi. Dy ministret e Mbrojtjes kanë diskutuar edhe për situatën në rajonin tonë, si dhe për zhvillimet në Ukrainë. Po ashtu, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli zhvilloi një takim të veçantë me drejtorin për Europën Qendrore dhe Jugore në Departamentin Amerikan të Shtetit, z. Jonathan Moore.

Z. Moore u shpreh se Shtetet e Bashkuara të Amerikës mbështesin Shqipërinë në çdo veprim që është duke ndërmarrë. Sa i takon statusit të vendit kandidat, kjo është një çështje që ka të bëjë me interesat e të dy vendeve tona, si anëtare të NATO. Këtë mesazh e kemi dhënë dhe në Tiranë, por mesazhet tona nuk mund të them se kanë rënë në veshë të shurdhër, por në veshë që nuk duan të dëgjojnë. Më tej z. Moore u shpreh se SHBA vlerëson kontributin që Shqipëria po jep në NATO. Ai shprehu edhe një herë mbështetjen në të gjitha nismat antikorrupsion të ndërmarra nga Ministria e Mbrojtjes, duke theksuar se është për t'u vlerësuar bashkëpunimi me Prokurorinë, duke e quajtur atë si një veprim të duhur në të tilla raste. "Asnjë person apo institucion nuk duhet të bëhet pengesë për progresin dhe ecurinë e reformave", - u shpreh z. Moore. Më tej, z. Moore ka theksuar se SHBA i kushton rëndësi të madhe sundimit të ligjit dhe inkurajon përpjekjet për të arritur qëllimet e përbashkëta. "Ne ju mbështesim plotësisht në përpjekjet tuaja për të mbrojtur dinjitetin dhe nderin e FA". Ndërsa ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli e informoi z. Jonathan Moore për hapat që janë duke u ndërmarrë në Ministrinë e Mbrojtjes. Gjithashtu, dy zyrtarët e lartë kanë diskutuaar edhe në lidhje me përpjekjet që po bën Mali i Zi për përmbushjen e kushteve për anëtarësimin në NATO si dhe për çështje që kanë të bëjnë me atë se çfarë do të jetë NATO pas 2014.

"Bashkëpunimi për siguri", Policia Ushtarake teston kapacitetet

Për disa ditë rresht, në rajonin stërvitor të Bizës efektivat e kompanisë operacionale të Policisë Ushtarake dhe të togës NATO Response Force (NRF), zhvilluan stërvitjen e koduar "Bashkëpunimi për siguri". Kjo stërvitje kishte si qëllim rritjen e kapaciteteve të Policisë Ushtarake për operacione të mbështetjes së paqes, të mbrojtjes kolektive, si dhe në përgjigje të katastrofave humanitare brenda vendit. Nëpërmjet kësaj stërvitjeje, trupat pjesëmarrëse testuan aftësitë operacionale të procedurave të punës në shtabet e nivelit taktik, si dhe të njohurive për planëzimin dhe ekzekutimin e operacioneve. Në Ditën e Vizitorëve të Shquar, efektivat e Policisë Ushtarake u inspektuan nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo dhe disa drejtorë drejtorish të Shtabit të Përgjithshëm. Pas paraqitjes së një brifingu nga drejtuesi i kësaj stërvitjeje, trupat e Policisë Ushtarake kanë demonstruar një kompleks elementësh stërvitor që i përgjigjeshin temës dhe qëllimit të kësaj stërvitjeje, si: sigurimin e rrugëkalimeve; sigurimin e bazës ushtarake dhe kundërveprimi ndaj sulmeve të grupeve terroriste; shoqërimi dhe sigurimi i personave të rëndësisë së veçantë etj. Gjeneralmajor Jeronim Bazo ka përgëzuar trupat e Policisë Ushtarake për ato çka kanë arritur gjatë këtyre ditëve, duke ngritur në një nivel më të lartë imazhin dhe dinjitetin e tyre, si dhe ka kërkuar një angazhim maksimal për përvetësimin e programeve stërvitore dhe standardizimin e procedurave të veprimit në tërë procesin stërvitor. Në këtë stërvitje morën pjesë edhe 7 vajza efektiv të Policisë Ushtarake, të cilat treguan aftësi dhe përkushtim të lartë në zbatimin e detyrave, përkrah kolegëve të tyre.

KONFERENCA E 8-TË E SHSHP TË BALLKANIT

Promovohet bashkëpunimi ushtarak dhe mirëkuptimi rajonal

U zhvillua në Bosnje-Hercegovinë, nga data 3 deri në 5 qershor, takimi i shefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve të Ballkanit

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, mori pjesë në takimin e shefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve të Ballkanit, që u zhvillua në Sarajevë, Bosnje-Hercegovinë nga data 3 deri 5 qershor 2014. Në këtë takim morën pjesë edhe përfaqësues të lartë nga Komitetit Ushtarak i NATO-s dhe i BE-së, Komanda e Forcës së Bashkuar të NATO-s, Napoli, Komanda e Amerikane në Evropë dhe misioni i BE-së në Bosnje-Hercegovinë. Temat kryesore që do u diskutuan midis vendeve në këtë takim, ishin bashkëpunimi ushtarak midis vendeve të Ballkanit, sidomos në fushat e edukimit, stërvitjes e trajnimit, shkëmbimit të informacionit për rreziqet dhe kërcënimit asimetrike si dhe provat e gatishmërisë për ndërlidhjen midis qendrave të bashkuara operacionale. Iniciativa e shefave të Shtabit të Përgjithshëm të vendeve të Ballkanit u formua me ndërmjetësimin e NATO-s në vitin 2007. Pjesë të kësaj iniciative janë Shqipëria, Greqia, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnje-Hercegovina, Serbia, Rumania, Bullgaria dhe Turqia. Shqipëria udhëhoqi sekretariatin e kësaj iniciative gjatë vitit 2012-2013 dhe organizoi takimin kryesor të SHSHP të vendeve të Ballkanit në Qershor 2013.

Të vendosur për të forcuar dhe zgjeruar bashkëpunimin

Pas përfundimit në Sarajevë, Bosnje dhe Hercegovinë, të Konferencës së 8-të të shefave të Shtabit të Ballkanit, përfundimet ishin njëzëri për zgjerim bashkëpunimi. Në dy ditët e takimit të tyre, shefat e Mbrojtjes së vendeve të Ballkanit, diskutuan se si të zhvillohen më tej projektet ekzistuese si dhe eksploruan mundësinë për aktivitete të tjera të cilat mund ta bëjnë bashkëpunimin më të ngushtë, më efektiv dhe më përfitues për rajonin dhe përtej tij në të ardhmen. Fatkeqësia natyrore me të cilën u përball Bosnje dhe Hercegovina dhe vende të tjera të rajonit vetëm pak javë më parë nuk mund të mbetej në asnjë mënyrë jashtë vëmendjes së shefave të Mbrojtjes të vendeve të Ballkanit. "Ajo çfarë ndodhi javë më parë, - u shpreh gjeneralmajor Bazo,- ishte një zile alarmi për të gjithë ne për të menduar ndryshe dhe për të bërë më shumë. Forume të këtij formati, - shtoi gjeneral Bazo, - le t'i përdorim si platformë ku shkëmbehen dhe çmohen idetë e gjeneruara. E në këtë kontekst do të isha i lumtur të shikoja ushtarakë nga vendet tuaja në Kursin e Lartë të Sigurisë dhe Mbrojtjes që Forcat e Armatosura të Shqipërisë në vijim të traditës, do të hapin pas pak muajsh. Të komunikojmë me njëri-tjetrin është gjithmonë më mirë se të luftojmë njëri-tjetrin".

Propozimi i një "Force Rajonale" (JOINT) për emergjencat

Agjencia kombëtare serbe e lajmeve, Tanjug, vuri më në dukje diskutimin mbi bashkëpunimin rajonal në lidhje me fatkeqësitë natyrore. Për këtë qëllim, pra për përballimin e këtyre fatkeqësive, sipas SHSHP të FA serbe, gjeneral Ljubisa Dikoviç, u diskutua edhe mbi krijimin e një force të përbashkët rajonale JOINT. Sipas gjeneral Dikoviç, kjo ide duket e përshtatshme si për pjesëtarët e Forcave të Armatosura të këtyre vendeve edhe për qeveritë respektove. Një pjesëmarrje e tillë do të mund të siguronte masa të efektshme përkundrejt fatkeqësive natyrore po aq sa do të mundësonte edhe fuqizimin e mirëkuptimit të përbashkët. Dikoviç është shprehur se kishte besim që kjo ide do të realizohej dhe se pjesëtarët e ushtrive të kësaj force rajonale do të bënin stërvitje të përbashkëta të paktën një herë në vit.

Sipas burimeve serbe, gjenerali Dikoviç dhe pjesëtarët e delegacionit serb kanë prezantuar edhe kapacitetet e bazës "Jug", në të cilën do të zhvillohet në mesin e vitit 2014, stërvitja shumëkombëshe "Ujku i platinit 2014" (Platinum Wolf 2014), me pjesëmarrjen e marinsave amerikanë, Gardës Kombëtare të Ohio-s dhe të forcave të armatosura të tjera nga rajoni, nën frymën e konceptit të NATO-s, "smart defense", si një qasje ndaj mbrojtjes rajonale ajrore të Ballkanit (Balkan Regional Approach to Air Defense (BARRD)).

Mali i Zi, akoma më pranë me NATO-n

Turqia dhe Mali i Zi, në datën 5 qershor 2014 firmosën një marrëveshje bashkëpunimi që mbulon fushat e teknologjisë, arsimimit dhe shkencës, raporton agjencia Anadolu. Këtë marrëveshje, e nënshkroi SHSHP të FA turke, gjenerali Necdet Ozel, me homologun e tij malazez, Admiral Dragan Samarcic, para se të fillonte Konferenca e 8-të e SHSHP të vendeve të Ballkanit. Gjeneral Ozel vlerësoi rolin e Malit të zi në ruajtjen paqes në Ballkan dhe shprehu shpresë për anëtarësimin e këtij vendi në NATO. Negociatat e anëtarësimit të Malit të Zi në NATO kanë filluar që në vitin 2010. Vendit iu ofrua MAP në vitin 2009, duke bërë kështu hapin final për aplikimin për anëtarësim. Sipas analizave, ka mundësi që Mali i Zi të anëtarësohet shumë shpejt në NATO. Ajo që duket qartë, është se siguria në rajon, vlerësohet si zhvillim i politikës së NATO-s: Zgjerimi sjell më shumë siguri.

A. Hitoaliaj

Atashetë ushtarakë të vendeve të NATO, të akredituar në Shqipëri, vizitë në komandën e Forcës Tokësore

Grupi i Atasheve Ushtarakë të vendeve të NATO-s me datë 3 qershor 2014, bëri një vizitë në Komandën e Forcës Tokësore. Ata u pritën në një takim të veçantë nga Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, i cili pasi ju uroi mirëseardhjen, shprehu mirënjohje dhe vlerësime pozitive për bashkëpunimin e deritanishëm, si dhe mbështetjen e dhënë në transformimin e Forcës Tokësore. Nga ana e tij, u garantua thellimi i këtij bashkëpunimi edhe në të ardhmen. Më tej aktiviteti vijoi me prezantimin e mbajtur nga zv/komandanti i Forcës Tokësore kolonel Dilver Hoxha me temë "Statusi dhe perspektiva e zhvillimit të Forcës Tokësore". Në mënyrë të përmbledhur atashetë u njohën me historikun, misionin, strukturën, vizionin, konceptet dhe transformimin e FT-së. Ndër çështjet kryesore që u ndërthurën me pyetje e përgjigje ishin Objektivat e Kapaciteteve (Capability Targets) të dhëna nga NATO. Vëmendje e veçantë ju kushtua zhvillimit të Grup Batalionit në planin afat-mesëm dhe afat-gjatë, si dhe Batalionit të Dytë të Këmbësorisë (b2k), përfshi kompaninë e parë të këmbësorisë (klk) të tij, deklaruar si Forcë e Reagimit e NATO-s (NRF), që i përket një objektivi afat-shkurtër. Komandanti i FT-së, e vuri theksin në mbështetjen e dhënë nga SHBA, Gjermania, Turqia, Italia për trupat shqiptare pjesëmarrëse në misionet jashtë vendit. Interesim pati për stërvitjen që do të zhvillohet gjatë këtij muaj "Biza 14", ku batalioni i dytë i këmbësorisë do të certifikohet sipas procedurave të NATO-s. N/Kolonel (CDR) Ralph Shield, Atasheu Ushtarak i SHBA-së, në emër të atasheve ushtarakë të tjerë falenderoi komandantin e FT-së për mikpritjen dhe informacionin e ofruar. Ai e vuri theksin edhe njëherë tek vlerat e bashkëpunimit dhe domosdoshmërinë e organizimit të aktiviteteve të tilla me qëllim koordinimin e ndihmave që mund të ofrojnë në të ardhmen.

Filloi stërvitja e përbashkët "JCET-2014" (Joint Combinet Exchage Traing)

Atasheu amerikan, vlerëson kontributin e FS shqiptare përkrah atyre amerikane në Afganistan

Më datë 2 qershor 2014 në ambientet e Batalionit të Forcave Speciale u zhvillua ceremonia e fillimit të stërvitjes së përbashkët "JCET-2014". Në këtë ceremoni mori pjesë komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku, Atasheu Ushtarak i SHBA-së, në vendin tonë, CDR, (nënkolonel) Ralph Shield dhe shefi i Zyrës së ODC, major Kristopher S. Mitchell. Trupat pjesëmarrëse në këtë stërvitje do jenë efektiv nga batalioni i Forcave Speciale të Forcës Tokësore, një grup i Forcave Speciale Renea të Ministrisë së Brendshme dhe grupi i 19-të i Forcave Speciale amerikane. Pas pritjes nga Komandanti batalionit të Forcave Speciale, nënkolonel Qazim Hoxha e mori fjalën Atasheu Ushtarak i SHBA akredituar në vendin tonë, CDR (nënkolonel) Ralph Shield, i cili vlerësoi arritjet Forcave Speciale shqiptare dhe kontributin e dhënë në mbështetje të paqes në Afganistan, përkrah forcave special amerikane. Ai theksoi se stërvitja e përbashkët do të shërbejë si një shkëmbim eksperience mes palëve pjesëmarrëse në stërvitje. Komandanti i Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushku në fjalën e tij përshëndetëse, pasi ju uroi mirëseardhjen trupave speciale amerikane dhe pjesëmarrësve suksese në zhvillimin e stërvitjes, vlerësoi bashkëpunimin me SHBA, kontributin e dhënë në transformimin e FA-së dhe ndihmesën e dhënë në drejtim të trajnimit të trupave speciale shqiptare. "Kjo stërvitje me pjesëmarrje të gjerë trupash do jetë një eksperiencë e re, ku secili do të mësojë nga eksperienca e njëri tjetrit dhe në përfundim të saj, kjo do të ndihmojë në rritjen e performancës dhe profesionalizmit". Temat që do të zhvillohen në këtë stërvitje do të fokusohen kryesisht në planizim detyre dhe ekzekutim të saj me trupa, dhënie të ndihmës së parë në fushën e luftimit, qitje me llojet e armëve që përdorin forcat special, në kërkim shpëtimit, etj. Kjo stërvitje do të shërbejë gjithashtu edhe për rritjen e rolit të nënoficerit në zgjidhjen e detyrave operacionale. Për zhvillimin e stërvitjes do të shfrytëzohet e gjithë infrastruktura e stërvitjes e batalionin të Forcave Speciale. Stërvitja do të ndahet në dy faza: Faza e parë në rajonin e Zall-Herrit tre javë dhe Faza e dytë në ishullin e Sazanit një javë.

Major Nexhbedin Basha

ANO certifikon kursantët e "Kursit të Lartë të Nënoficerit"

Në Akademinë e Nënoficerëve, në datë 30 maj 2014, u bë certifikimi i kursantëve të kursit të 15-të të Lartë të nënoficerit në ANO, i cili zgjati 8 javë dhe u ndoq nga 29 kursantë. Ky kurs nëpërmjet programit që përbëhej në dy faza në atë teorike, të zhvilluar në ambientet e klasave si dhe atë praktike, të zhvilluar në teren, ka bërë të mundur rritjen e aftësive të specialistit të shtabit. Këto kurse kanë synuar kryesisht në rritjen e rolit të tyre si drejtues të një niveli më të lartë, marrjen e përgjegjësive dhe përmbushjen e misionit që ju caktohet sipas kërkesave dhe standardeve të NATO-s. Në këtë ceremoni mori pjesë shefi i Shtabit i KDS-së kolonel Riza Zaja, Z. Dee Esplin dhe përfaqësues të tjerë të CUBIC-ut dhe Qendrës së Simulimit. Gjatë fjalës së tij Kolonel ZAJA theksoi rëndësinë e përvetësimit të programeve mësimore që ky kurs ofron, përcjelljen e këtyre njohurive në njësitë e repartet në të cilat kursantët shërbejnë. Ai kështilloi që çdo rekomandim dhe sugjerim që kursantët kanë t'ia përcjellin instruktorëve e komandantëve të tyre në funksion të rritjes dhe përmirësimit të mësimdhënies dhe programit mësimor që ANO ofron. Duke mbyllur fjalën e tij kolonel Zaja falenderoi dhe uroi edhe njëherë zv/komandantin e ANO-së n/kolonel Muhamed Guza, komandantin e kursit major Kujtim Zeka, instruktorët e kursit, si dhe të gjithë kursantët e sapocertifikuar, të cilët ndihmuan për përfundimin me sukses të këtij kursi, duke u shprehur besimin në punën dhe bashkëpunimin e tyre të mëtejshëm. Me qëllim rritjen e performancës së kursit dhe motivimin e mëtejshëm të kursantëve, Akademia e Nënoficerëve ka filluar të aplikojë dhënien e Certifikatës së Mirënjohjes nga Komandanti i Akademisë për kursantin më të dalluar, bazuar kjo në listë-meritën e rezultateve të gjithsecilit. Kursanti me rezultatet më të larta për këtë kurs ishte Dashamir Disha. Ceremonia u mbyll me shpërndarjen e certifikatave dhe realizimin e një fotoje të përbashkët.

Flotilja Detare Pashaliman, zhvillon qitjet bregdetare

Efektivi i Flotiljes Detare Pashaliman, në datën 29 maj 2014, në poligonin e qitjeve bregdetare Bristan-Kepi Gjuhëzës, zhvilloi qitjet me mitraloz 12.7 mm kundër objektivave bregdetare. Qitja u zhvillua dhe u drejtua nga shefi i Shtabit të Flotiljes Detare Pashaliman, kapiten i rangut të II-të Bamir Likaj. Gjithashtu, morën pjesë dhe nga shtabi i Forcës Detare, shef i Degës Operacionale kapiten i rangut të II-të Engjell Sinanaj, shef i Degës BCU, nënkolonel Leti Sulaj dhe anëtare të tjerë të shtabit. Në qitje morën pjesë tre anije P-116, P-117, P-03 anije të Flotiljes Detare Pashaliman.

KDS, vizitë e një ekipi të "Akademisë së Nënoficerit" të Turqisë

Në kuadër të bashkëpunimit bilateral midis të dy vendeve Shqipëri-Turqi në fushën e mbrojtjes e arsimimit ushtarak, zhvilloi një vizitë njohëse njëditore në mjediset e KDS, Kursi i Nënoficerit i Akademisë së Nënoficerit i Turqisë. Ekipi drejtues i kursit të nënoficerëve turq, u prit në një takim kortezie nga zv/komandanti i KDS, kolonel Rruzhdi Kuçi. Në këtë takim mori pjesë dhe atasheu ushtarak turk i akredituar në vendin tonë, kolonel Nizamettin Doğan. Më pas, nëpërmjet një brifingu të mbajtur nga përfaqësues të ANO, u prezantua në vija të përgjithshme funksionimi i sistemit arsimor e trajnues ushtarak për nënoficerët në Akademinë e Nënoficerëve në KDS. Turi i vizitës së afro 100 kursantëve nga Akademia turke u përmbyll me një vizitë kulturore në Muzeun e FA.

Samiti i komandantëve të FD të Europës: E ardhmja vendoset nga deti

Samiti i Komandantëve të Forcave Detare të Europës (CHENS) është një forum jopolitik i cili formohet me pjesëmarrjen e komandantëve të FD të shteteve të BE-së dhe vendeve anëtarë të NATO-s. Qëllimi i CHENS është promovimi i mirëkuptimit ndërmjet FD të vendeve anëtare, marrja në shqyrtim e çështjeve me interes të përbashkët brenda kuadrit strategjik si dhe rritja e ndërgjegjësimit publik për mjedisin detar. Dokumentet të cilët prodhohen nga grupet e punës nën udhëzimin e CHENS janë të rëndësishëm për të pasqyruar mendimin profesional të drejtuesve më të lartë të forcave detare të Europës në lidhje me çështjet detare. Ky mendim i unifikuar profesional përbën bazat e kuadrit këshillues për politik-bërësit e vendeve europiane në lidhje me sigurinë në mjedisin detar. Forca Detare shqiptare është anëtare me të drejta të plota në CHENS që nga viti 2010. CHENS 2014 zhvilloi punimet më datë 22-23 maj 2014, nën kryesimin e radhës të FD Britanike, në Portsmouth, Britani e Madhe, një qytet me tradita të mëdha detare, ku ndodhet edhe një bazë e forcës detare dhe një nga muzetë më të vjetër e më të bukur të historisë së luftërave detare në botë. Tematika e samitit ishte rëndësia e forcës detare në sigurinë rajonale dhe globale.

Siguria detare në kontekstin e ri strategjik

Sh.T.Z Philip Hammond, Sekretar Shteti për Mbrojtjen, në fjalën e tij përshëndetëse, nënvizoi rëndësinë që kanë operacionet detare dhe ato bregdetare për të mbështetur vullnetin politik në kuadër të sigurisë rajonale dhe më gjerë. Ky mendim u zhvillu më tej nga admiral Sir George Zambellas, Lord I-rë i Detit, dhe komandant i Forcës Detare të Mbretërisë së Bashkuar, i cili hodhi dritë mbi rëndësinë që merr siguria detare në kontekstin e ri strategjik që formohet me përfundimin e ISAF, i cili ishte një operacion i madh me fokus tokësor, me SHBA e cila do të përpiqet të riekuilibrojë teatrin aziatik-paqësor dhe me zhvillimet e papritura në Ukrainë. Admiral Zambellas sugjeroi se FD e Europës duhet të marrin më shumë përsipër për të lehtësuar SHBA dhe ftoi pjesëmarrësit të mendojnë për të zhvilluar një kontribut detar europian më të përshtatshëm, më të saktë dhe më të përdorshëm jo vetëm në detin e hapur por edhe në hapësirat bregdetare, të cilat janë më komplekse si nga ana ushtarake ashtu dhe ajo politike. Ai vuri theksin tek mundësitë që kanë FD të Europës për të ushtruar influencë dhe efekt më të madh nëpërmjet dhënies rëndësi operacioneve bregdetare, kuptimit të situatës detare para lindjes së krizave si dhe përmirësimit të performancës detare të NATO-s.

Një Strategji Europiane për Sigurinë Detare

Komisonierja Europiane për Çështjet Detare, Maria Damanaki, mendon se BE ka pritshmëri të mëdha për FD Europiane në lidhje me rolin e tyre për sigurinë detare dhe prosperitetin". Znj. Damanaki vë theksin tek mundësitë e mëdha që ndodhen në sektorin detar për të krijuar vende pune dhe rritje ekonomike, e quajtur "Blue Growth". Eurokomisionerja prezantoi draft Strategjinë për Sigurinë Detare Europiane, e cila është duke u shqyrtuar në Këshillin e Europës. Strategjia në fjalë bazohet në principet e koherencës, bashkëpunimit ndërsektorial dhe kostos efektive. Kjo strategji do të ndërlidhë të gjitha politikat e brendshme të shteteve të BE-së me politikat e tyre të jashtme në mënyrë që të përmirësohet bashkëpunimi civiloushtarak. Strategjia do të pasohet edhe nga një plan veprimi konkret i cili do të parashikojë një ndërthurje dhe një bashkëpunimin më të madh midis agjencive civile, sipërmarrësve privatë dhe forcave detare të vendeve europiane me qëllim rritjen e efikasitetit dhe uljen e kostos për arritjen e sigurisë në mjedisin detar.

Potenciali i Forcës Detare për projektimin e forcës

Në samit prezantuan tema edhe ushtarakë të lartë, përfaqësues të NATO-s, akademikë dhe ekspertë të cilët bashkërisht nxorën në pah rëndësinë që duhet të marrë projektimi i forcës nga deti, operacionet amfibe dhe operacionet detare në afërsi të brigjeve. Folësit ngritën shqetësimin se politika ka dështuar të kuptojë realitetin gjeopolitik aktual dhe rëndësinë e Forcave Detare në këtë kuadër. Gjithashtu u kritikua përfaqësimi i vogël i forcave detare në komandat dhe shtabet e NATO-s.

FD shqiptare, në pararojë për bashkëpunimi ndër-institucional për sigurinë detare

Interes të veçantë ngjalli studimi i prezantuar në Samit mbi bashkëpunimin ndër-institucional për sigurinë detare, i cili përforcon konceptin tonë "një flotë dy misione." Ky studim kristalizon idenë se mbajtja e forcës detare është e domosdoshme, por ajo duhet të përshtatet me natyrën e rreziqeve të ambientit të sigurisë. Sot Forcat Detare të Europës i shohim gjithmonë e më shumë të përfshihen në detyra dhe operacione të Rojës Bregdetare duke marrë përsipër gjithmonë e më shumë përgjegjësi të karakterit civil. Kjo është e vetmja mënyrë që ul koston e madhe që ka siguria detare. Në këtë pikëpamje, forca jonë detare, nga ana konceptuale, është në pararojë të forcave detare të Europës. Forca jonë detare zëvendësoi anijet e vjetra luftarake me anije të reja shumëfunksionëshe të klasit "Iliria" të përshtatshme për të kryer një sërë detyrash në kuadër të sfidave të sigurisë të shekullit tonë. Gjithashtu FD mori përsipër misionin e rojës bregdetare, promovoi dhe mbështeti bashkëpunimin ndërinstitucional e cila u kurorëzua me ngritjen e QNOD-së, një nga strukturat e para në Europë, e cila mbështetet mbi bashkëpunimin e ngushtë dhe bashkërendimin e përpjekjeve ndërmjet të gjitha institucioneve detare për zbatimin e ligjit në det dhe arritjen e sigurisë në mjedisin detar. Samiti paralajmëroi rol më të madh për Forcën tonë Detare edhe në kuadër të NATO-s. NATO po mendon ristrukturimin e grupeve të anijeve të (SNMG) me qëllim përshtatjen me mjedisin e ri të sigurisë. Grupet detare të NATO-s (SNMG) pritet të organizohen me anije shumëfunksionëshe të afta për të kryer misione detare të shkallëve të ndryshme. Në këtë kuadër mund të hapen dritare mundësish për anijet e FD për të ofruar kontributin e tyre modest për sigurinë detare. Gjatë aktiviteteve sociale, komandanti i FD u takua me komandantin e FD britanike admiral Sir Zambellas, me të cilin u diskutuan parimisht çështje të bashkëpunimit dypalësh në një frymë shumë të ngrohtë dhe miqësore. Admiral Zambellas veçanërisht u ndal në rëndësinë e bashkëpunimit me FD shqiptare në kuadër të stërvitjes "Albanian Lion 2014" e cila do të zhvillohet në Shqipëri në muajin shtator. Samiti i ardhshëm do të zhvillohet në Itali nën temën: Nga rolet tradicionale në sfidat aktuale të sigurisë: Si t'i përshtatim forcat detare në raport me botën që ndryshon me shpejtësi" FD shqiptare do të marrë pjesë në grup pune për të përgatitur një studim me temën "Sigurimi i kufijve detar me resurse të kufizuara."

Kapiten Lejtnant Dorian Tola

Çdo fëmijë është më shumë se një engjëll, është diçka që i tejkalon kufijtë e humanes, që të lidh me një diçka që është shumë e rëndësishme, që është trashëgimia që kemi lënë nëpërmjet dashurisë që transmetojmë për të rritur fëmijët qytetarë të denjë të shoqërisë dhe kjo është gjëja që nuk duhet të na mungojë kurrë

1 Qershori

QKMB, aktivitet festiv me rastin e 1-Qershorit

Në kuadër të 1-Qershorit, Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve, Qendra e Kulturës, Medias dhe Botimeve të Mbrojtjes zhvilloi në mjediset e Ministrisë së Mbrojtjes, një aktivitet me pjesëmarrjen e fëmijëve të ushtarakëve, të cilët ndjekin kurset artistike pranë kësaj qendre. Në këtë veprimtari ishin të pranishëm ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm së FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, drejtorë dhe ushtarakë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm, fëmijë të ushtarakëve, prindër dhe të afërm të tyre, etj.

Fillimisht, të pranishmit ndoqën performancën e fëmijëve së ekipeve sportive në shesh si karate, tërheqje litari, kala dibrançe, etj. Më pas, ata vizituan ekspozitën me punime nga fëmijët e kursit të arteve pamore pranë sektorit të rekreacionit. Në vijim, grupet e fëmijëve të këngës, recitimit, instrumenteve, etj, dhanë një koncert në sallën e shfaqjeve. Aty pati kolazh me këngë së fëmijëve në vite, kolazh me hite të muzikës së lehtë si dhe kënget "Jemi 1 e s'jemi 2". Me shumë interes u ndoq edhe kënga "Bashkë me fëmijët", kënduar nga këngëtari Kozma Dushi së bashku me grupin e këngëve si dhe kënga "Për mbi shtregull kolovitem" kënduar nga këngëtari Ervin Bushati me fëmijët. Recitime si: "Vjersha e 1-Qershorit", "Luli i parritur", "Kërcimi i lumturisë" e më pas u perfomuan në kitarë pjesë si: Kënga e "Maturës", "Lojë në kitarë", "Mos prit deri nesër" e në piano pjesë si: "Vallja e Peshkopisë" dhe "Simfonia nr. 9 e Beethoven".

Fjalën hapëse të këtij aktiviteti e mbajti drejtori i Përgjithshëm i QKMBM, z. Jakin Marena, i cili, pasi uroi fëmijët për festën e 1-Qershorit, u shpreh: "Çdo investim i sigurt tek fëmijët është një garanci për të ardhmen. Hapa seriozë janë marrë, por hapa të tjerë të rëndësishëm do të merren dhe angazhimi i qeverisë dhe shoqërisë do të jetë gjithnjë e më i madh. Kjo festë vjen si ogur i mirë, besim e dëshirë e plotë për të gjithë shqiptarët, sepse ky qershor është muaji më i rëndësishëm për integrimin e Shqipërisë".

Përshëndetjen e radhës në këtë ditë feste, e bëri ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, e cila pasi uroi fëmijët e ushtarakëve gëzuar 1-Qershorin, theksoi se, çdo fëmijë është më shumë se një engjëll, është diçka që i tejkalon kufijtë e humanes, që të lidh me një diçka që është shumë e rëndësishme, që është trashëgimia që kemi lënë nëpërmjet dashurisë që transmetojmë për të rritur fëmijët qytetarë të denjë të shoqërisë dhe kjo është gjëja që nuk duhet të na mungojë kurrë. Më tej, znj Kodheli nënvizoi se, puna që unë bëj, mundi që jap, rrjedh nga një nënë që e di se ç'është e ardhmja për fëmijët. Prandaj, u shpreh ajo, nuk duhet të rreshtim së punuari për rritjen dhe edukimin e fëmijëve tanë, për t'i dhënë atyre dinjitetin që meritojnë, të ardhmen që meritojnë, të ardhmen europiane.

Fëmijët e kursit të pikturës, i dhuruan ministres së Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli dhe shefit të Shtabit së Përgjithshëm të Forcave së Armatosura të Republikës së Shqipërisë, z. Jeronim Bazo, dy piktura simbolike të bëra nga vetë vogëlushët që kanë punuar gjatë gjithë vitit. Me këtë rast, znj. Kodheli u shpreh: "Shumë pak vetë e dinë që unë kam fatin, për shkak të mbiemrit që mbaj, ditën që jam martuar, të kem shumë piktura në muret e shtëpisë sime, sepse gjyshi i djalit tim, është ndoshta një nga piktorët më të mëdhenj të historisë së artit shqiptar, nderi i kombit, Kel Kodheli. E them këtë gjë, sepse kam një ligj absolut në shtëpi që nuk mund të var asgjë tjetër në mur, përveçse pikturat e Kelit, por kjo pikturë që m'u dhurua sot do të rrijë në murin e shtëpisë time". Kremtimi i festës së 1-Qershorit dhe koncerti i bukur që u shfaq është shprehje e punës dhe i kujdesit që tregon Ministria e Mbrojtjes dhe Qendra e Kulturës, Medias e Botimeve të Mbrojtjes për kremtimin e ditë festave të rëndësishme si dhe për pasurimin e jetës kulturore në Forcat tona të Armatosura.

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, shefi i Shtabit të Përgjithshëm së FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo dhe drejtori i Përgjithshëm i QKMBM, Jakin Marena duke vizituar ekspozitën me punime nga fëmijët e kursit të arteve pamore pranë sektorit të rekreacionit.

"Shumë pak vetë e dinë që unë kam fatin, për shkak të mbiemrit që mbaj, ditën që jam martuar, të kem shumë piktura në muret e shtëpisë sime, sepse gjyshi i djalit tim, është ndoshta një nga piktorët më të mëdhenj të historisë së artit shqiptar, nderi i kombit, Kel Kodheli. E them këtë gjë, sepse kam një ligj absolut në shtëpi që nuk mund të var asgjë tjetër në mur, përveçse pikturat e Kelit, por kjo pikturë që m'u dhurua sot do të rrijë në murin e shtëpisë time"

"Çdo investim i sigurt tek fëmijët është një garanci për të ardhmen. Hapa seriozë janë marrë, por hapa të tjerë të rëndësishëm do të merren dhe angazhimi i qeverisë dhe shoqërisë do të jetë gjithnjë e më i madh. Kjo festë vjen si ogur i mirë, besim e dëshirë e plotë për të gjithë shqiptarët, sepse ky qershor është muaji më i rëndësishëm për integrimin e Shqipërisë"

Fjala e Ministres së Mbrojtjes, Mimi Kodheli, në festën e 1 qershorit, të organizuar nga QKMBM

Ministrja Kodheli: Nuk duhet të rreshtim së punuari për rritjen dhe edukimin e fëmijëve tanë

Në këtë ditë feste, ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, u shpreh: "Mua më kujtohet shumë mirë kur djali im ishte në moshën e këtyre fëmijëve këtu. Më kujtohet çdo moment, çdo ditë, çdo natë e mundimit që një nënë bën për të rritur një fëmijë. Koha kalon shumë shpejt, kur e shikoj djalin tim sot që është një burrë, më duket sikur ma kanë dhuruar kaq sa është. Është shumë e bukur që ne të mund të kujtojmë të gjithë atë energji pozitive që kemi transmetuar e transmetojmë tek fëmijët tanë. Të gjithë atë mund, impenjim, dashuri që kemi transmetuar e mund të transmetojmë akoma tek fëmijët tanë. Unë kam qenë një vajzë me tipare të theksuara të një djaloshi, në kuptimin që matesha me djemtë, merresha me sport, preferoja të vishja pantallona në vend që të vishja fustan. Dikur ne jemi rritur me letërsi, me një vepër, që shumëkush nga brezi im e kujton shumë mirë: "Sikur të isha djalë". Unë kam menduar shpesh herë pse nuk u bëra djalë. Ka më shumë favore të qenit djalë, flas për atë periudhë të jetës, por kam falënderuar Zotin dhe nënën time në të gjitha momentet e jetës, sidomos momentin kur jam bërë nënë. E kam thënë që është shumë mirë të jesh nënë, madje është kaq mirë, sa është një gjë e cila e lidh qenien njerëzore me hyjnoren. Ka diçka në atë moment që nuk ka të bëjë me të jetuarit e përditshëm, me atë çka çdo ditë bëjmë, flasim, punojmë, mësojmë, ecim, këndojmë, qajmë, ka shumë më shumë se kaq. Dhe është fëmija që sjell në jetë. Çdo fëmijë është më shumë se një engjëll, është diçka që i tejkalon kufijtë e humanes, që të lidh me një diçka që është shumë e rëndësishme, që është trashëgimia që kemi lënë nëpërmjet dashurisë që transmetojmë për të rritur fëmijët qytetarë të denjë të shoqërisë dhe kjo është gjëja që nuk duhet të na mungojë kurrë. Trashëgimia që ne lëmë nëpërmjet dashurisë që transmetojmë për t'i rritur fëmijët qytetarë të denjë të shoqërisë, është gjëja që nuk duhet të na mungojë kurrë dhe prindërve shqiptarë kjo nuk u mungon. Ndaj unë besoj që jam këtu jo vetëm për ta ndarë këtë ndjesi krejt humane të qenit prind me ju, por më shumë se kaq, unë jam këtu për t'i garantuar prindërit që janë në këtë sallë dhe ata që janë jashtë kësaj salle, se ashtu si luftoj çdo ditë, mendoj, punoj, sakrifikoj, për të ardhmen e djalit tim, që është gjëja më e shtrenjtë që unë kam, ashtu e bëj këtë edhe për çdonjërin prej jush dhe për çdo fëmijë që është këtu në sallë apo jashtë saj, sepse puna që unë bëj mundi që unë jap, buron nga një nënë, e cila e di çfarë do të thotë e ardhme e një fëmije, që është e ardhmja e të gjithëve ne. Ndaj besojeni kështu siç po ja u them: Nuk do të rresht së punuari, bashkë me kolegët e mi, për ta bërë Shqipërinë pak më të mirë se ajo e djeshmja që pastaj dhe këta fëmijë ta bëjnë pak më të mirë se sa kjo e sotmja. E kështu pak nga pak t'i japim dinjitetin që meriton vendit tonë dhe t'i japim të ardhmen që fëmijët tanë meritojnë. Një të ardhme europiane, të vërtetë, të prekshme, që vjen, që buron nga Shqipëria dhe që fëmijët tanë nuk do ta gjejnë jashtë kufijve të këtij vendi. Kjo është shumë e rëndësishme që ta ndaj me ju, ndaj uroj shumë që 1-Qershor të jetë çdo ditë e vitit, sepse fëmijët tanë meritojnë shumë më shumë nga vetëm një ditë festë. Ju faleminderit e gëzuar edhe një herë 1-Qershorin"!

Fjala e drejtorit të Përgjithshëm të QKMBM-së, Jakin Marena, në festën e 1 qershorit, të organizuar nga QKMBM

Marena: Kjo festë vjen si ogur i mirë, për të gjithë shqiptarët, sepse ky qershor është muaji i integrimit

Në fjalën e tij, ndër të tjera, z. Marena tha: "Të nderuar pjesëmarrës, sot është 1-Qershori, dita e fëmijëve, dita e lumturisë së tyre, ndaj le t'i urojmë të gjithë së bashku, këta fëmijë në tërësi: Gëzuar të gjithë këtë ditë të lumtur! Që ëndrrat e tyre më të bukura të bëhen të vërtetat e jetës së tyre! Shqipëria duhet të ndërtohet e bukur, siç ka të bukur edhe këta fëmijë dhe ne duhet të bëjmë gjithçka për ta se e meritojnë. Çdo investim i sigurt tek fëmijët është një garanci për të ardhmen. Hapa seriozë janë marrë, por hapa të tjerë të rëndësishëm do të merren dhe angazhimi i qeverisë dhe shoqërisë do të jetë gjithnjë e më i madh. Kjo festë vjen si ogur i mirë, besim e dëshirë e plotë për të gjithë shqiptarët, sepse ky qershor është muaji më i rëndësishëm për integrimin e Shqipërisë. Le të gëzojmë së bashku me fëmijët tanë, ndaj ju ftoj dhe njëherë të festojmë së bashku. Shoqëria ka nevojë sot më shumë se kurrë të promovojë pozitivitetin, solidaritetin, dashurinë dhe buzëqeshjen për fëmijët tanë, për të sotmen dhe për të ardhmen e tyre. Gëzuar edhe një herë"!

Një përshëndetje nga Afganistani

Eksperienca në ISAF, hap cilësor i modernizimit të personelit të FA

Kapiten Skedilajt Bele*

Prej janarit 2014 dhe në vazhdim shtatëdhjetë e katër, oficerë dhe n/oficerë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, vazhdojnë të kryejnë detyrën fisnike si pjesë përbërëse e koalicionit të Forcës Ndërkombëtare të Ndihmës dhe Sigurisë (ISAF) në misionin "Enduring Freedom" në Afganistan. Pjesëmarrës në tre nivele të ndryshme përfaqësimi ushtarakët shqiptarë po kryejnë me sukses dhe profesionalizëm detyrën. Konkretisht Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë përfaqësohen me dymbëdhjetë oficerë me detyra të ndryshme në një pjesë të mirë të shtabeve dhe komandave kryesore të ISAF-it, me ekipin këshillues të Shtabit të një Brigade Afgane prej dymbëdhjetë oficerësh dhe nënoficerësh të quajtur MAT "Striking Eagles – 5", si edhe me kontingjentin "EAGLE-8" të Forcave Speciale prej pesëdhjetë oficerësh dhe nënoficerësh. N/Kolonel Etor Shehu përfaqësuesi më i lartë ushtarak i Forcave të Armatosura të Shqipërisë në Afganistan, bazuar në vlerësimet e mira, respektive dhe periodike të komandave të ISAF-it, shpreh mirënjohjen dhe vlerësimin për të gjithë trupën e ushtarakëve shqiptarë që aktualisht ndodhet me mision në Afganistan. Më tej n/kolonel Shehu, ndalet në një nga nivelet më domethënëse të përfaqësimit të Forcave të Armatosura Shqiptare në Afganistan, në përfaqësimin me oficerë në shtabet e ndryshme të ISAF-it si një nga nivelet më të vlerësueshme dhe koherente. Nuk është e lehtë të shpjegosh të gjithë gamën e detyrave dhe përgjegjësive, por me plot bindjen mund të them që oficerët tanë kanë treguar vlerat më të mira gjatë gjithë kohës së kryerjes së detyrës në teatrin e operacionit. Përgatitja individuale dhe performanca në detyrë e oficerëve tanë me detyra në shtabet dhe komandat e ISAF-it ka marrë vlerësimet e merituara nga kolegët dhe përfaqësuesit më të lartë ushtarakë të NATO-s në Afganistan, por edhe nga ministrja e Mbrojtjes Mimi Kodheli dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA gjeneralmajor Jeronim Bazo, të cilët vetëm para tre javësh ishin mes nesh. Nga sa më lart vazhdojnë të kryejnë detyrën me përkushtim dhe devotshmëri sipas Komandave; Në Komandën e Forcave të Koalicionit (ISAF HQ), n/kolonel Etor Shehu me detyrë shef seksioni dhe oficer shtabi në Drejtorinë e Planifikimit Operacional; n/kolonel Gjyljan Pashaj me detyrë këshilltar/oficer shtabi për logjistikën, në Grupin e Këshillimit në Ministrinë e Brendshme Afgane dhe n/kolonel Ilirjan Zeqaj me detyrë këshilltar/oficer shtabi për operacionet në Ministrinë e Mbrojtjes Afgane. Në Komandën e Bashkuar Ndërkombëtare (IJC), n/kolonel Presim Ferataj me detyrë oficer shtabi për trajnimet dhe mësimet e nxjerra në Drejtorinë e Stërvitjes; kapiten Skerdilajt Bele me detyrë zëvendës shtypi/analist i mediave në Drejtorinë e Marrëdhënieve me Publikun dhe kapiten Vilson Qevani me detyrë zv/shef i automatizimit Logjistik në Grupin Logjistik të Komandës për Siguri dhe Transformim në Afganistan. Në Komandën Rajonale Perëndimore (RC-W), n/kolonel Arben Zani me detyrë Oficer Shtabi për planifikimin e stërvitjes operacionale në Drejtorinë e Stërvitjes; major Ilir Hysenaj me detyrë shef i seksionit të planeve logjistike në Drejtorinë Logjistike; major Klodian Kule me detyrë oficer shtabi për operacionet aktuale në Drejtorinë e Operacioneve dhe Toger Ardian Prençi me detyrë në strukturat e zbulimit të NATO-s. Në Komandën dhe shtabin e Forcave Speciale (NSOCC/SOF HQ), major Edvis Spahi dhe kapiten Arben Hasimllari me detyra si oficer shtabi për zbulimin. Në Komandën Rajonale – Qendrore (RC-C), operon dhe kryen detyra për herë të parë në nivel Brigade ekipi këshillues MAT "Striking Eagles – 5", i cili jo vetëm këshillon por edhe mbështet planizimin operacional të Shtabit të një Brigade Afgane. Ky ekip është i përbashkët me palën amerikane, drejtohet nga Kolonel Ardian BALI dhe përbëhet prej njëzetë e katër oficerësh dhe nënoficerësh, dymbëdhjetë shqiptarë dhe dymbëdhjetë amerikanë (pjesë e Gardës Kombëtare të Shtetit të New Jersey). Në Komandën Rajonale – Jugore (RC-S) operon dhe kryen detyra të ndryshme operacionale dhe luftarake në bashkëpunim me palën amerikane kontingjenti i Forcave Speciale i quajtur "EAGLE-8", i drejtuar nga Major Agron Kuta dhe i përbërë pesëdhjetë oficerësh dhe nënoficerësh. Vlen për tu theksuar që për herë të parë që prej janarit dhe shkurtit 2014, oficerët Shqiptarë kryejnë dhe kontribuojnë në një sërë detyrash të rëndësishme si: këshilltarë në Ministrinë e Brendshme dhe Ministrinë e Mbrojtjes ose në dy prej Institucioneve kryesore të Forcave të Sigurisë Afgane, por edhe si oficerë shtabi në komandën e Forcave Speciale dhe zv/shtypi në zyrën e shtypit në Komandën e Bashkuar Ndërkombëtare. Duke patur parasysh rrjedhën e ngjarjeve si dhe momentet historike që kanë përshkuar Afganistanin prej Janarit 2014 dhe deri më tani, si përfaqësuesi më i lartë ushtarak me detyrë në ISAF Afganistan ndjehem krenar nga profesionalizmi dhe përkushtimi i oficerëve tanë, pasi të ushtrosh detyrën në një terren të tillë plot sfida dhe të panjohura si dhe larg familjes kërkon jo vetëm profesionalizëm ushtarak dhe përkushtim, por mbi të gjitha përshtatje dhe bashkëjetesë në kushte të barabarta ndërmjet forcave të koalicionit, të cilin ushtarakët shqiptarë e kanë arritur plotësisht dhe me dinjitet të admirueshëm, duke treguar vlera të spikatura organizative, trajnuese e këshilluese në përmbushjen me aftësi, profesionalizëm dhe dinjitet detyrat e ngarkuara dhe të marra përsipër, përkrah Aleatëve dhe partnerëve. Bashkëjetesa dhe bashkëpunimi në kushte të tilla ndërmjet forcave të koalicionit shërben dhe është si një mekanizëm më se normal në shkëmbim eksperiencash por edhe një mundësi e pazëvendësueshme në rritjen e mëtejshme profesionale. Pra eksperienca e fituar në përfaqësimin në nivele, detyra dhe misione të tilla mendoj se është një ndër hapat më cilësor dhe real të modernizimit të mëtejshëm të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, pasi duke ndikuar ndjeshëm në rritjen profesionale ka mundësuar edhe perfeksionimin e punës sipas standardeve e procedurave të punës në shtabe nga ushtarakët tanë. Në të njëjtën kohë kjo eksperiencë do të shërbej në përfaqësimin sa më dinjitoz të Forcave të Armatosura në nivelet e ndryshme të bashkëpunimit dhe të angazhimit brenda strukturave të NATO-s. Bashkëpunimi në nivele të tilla bazuar në shkëmbimin eksperiencave në ndërthurje të plotë me kulturën e punës është një nga kërkesat aktuale të NATO-s, si dhe është një sfidë që gjithë vendet anëtare të NATO-s angazhohen në mirëkuptim të plotë. Modernizimi i mëtejshëm i kapaciteteve të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është bazuar në themele të forta, pikërisht në atë që shumëkush prej nesh ka mundur të përvetësoj gjatë trajnimeve, angazhimeve dhe kryerjes së detyrave të ndryshme brenda strukturave të NATO-s. Ndërtimi i një force bashkëkohore dhe moderne na ngarkon me përgjegjësi, detyrime dhe kërkesa për të qenë në sintoni të plotë dhe kurdoherë me vendet e tjera aleatë në NATO. Në përfundim përshëndes dhe falenderoj, gjithë trupën e ushtarakëve shqiptarë të angazhuar në misionin "Enduring Freedom" në Afganistan, për përkushtimin bashkëpunimin dhe devotshmërinë e treguar në përmbushjen me sukses të detyrave të ngarkuara në mision, për shfaqjen e vlerave më të larta e më të mira që përfaqëson ushtaraku i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, duke na bërë të ndjehemi gjithnjë krenar për punën tonë mes Aleatëve dhe partnerëve edhe këtu në Afganistanin e largët. Forcat e Armatosura dhe Shqipëria, duhet të jenë krenarë për këta djem, për këta ambasadorë realë të paqes dhe lirisë, në Afganistanin e largët!

Modernizimi i mëtejshëm i kapaciteteve të personelit të Forcave të Armatosura është bazuar në themele të forta, pikërisht në atë që shumëkush prej nesh ka mundur të përvetësoj gjatë trajnimeve, angazhimeve dhe kryerjes së detyrave të ndryshme brenda strukturave të NATO-s. Ndërtimi i një force bashkëkohore dhe moderne na ngarkon me përgjegjësi, detyrime dhe kërkesa për të qenë në sintoni të plotë dhe kurdoherë me vendet e tjera aleatë në NATO.

*** Analist i medieve**
Drejtoria e Marrëdhënieve me Publikun,
Komanda e Bashkuar Ndërkombëtare (IJC), Kabul Afganistan

Sigurimi i ushqimit, kyçi i zgjidhjes tashmë është këtu

Bjorn Lomborg*

Bjorn Lomborg argumenton se ndikimet e ngrohjes globale në pamjaftueshmërinë e ushqimit mund të shqyrtohen – dhe që tani. Për më tepër, ai paraqet një pamje në të cilën më pak njerëz në botë do të vuajnë nga uria, pavarësisht nga rritja e popullsisë. Këtu ai parashtron veprimin që duhet të ndërmerret tani. Le të ndjekim analizën e tij, e cila duket se është dimension i ndryshëm nga ai i Mbrojtjes, por është pa dyshim brenda dimensionit të Sigurisë.

Shpesh na është thënë se ngrohja globale së shpejti do ta bëjë të pamundur ushqyerjen e planetit. Ky zmadhim i tepruar i së vërtetës na çon drejt zgjidhjesh të gabuara. Kur Qendra e Konsensusit e Kopenhagës mblodhi një grup ekspertësh fitues të Çmimit Nobel për të përcaktuar investimet më të mira që mund të bëhen për të ndihmuar planetin, ata nënvizuan mënyra shumë të dobishme dhe me çmim mjaft të ulët për të luftuar kequshqyerjen, si nëpërmjet shtimit të mikroushqyesve joorganikë, pasurimit me lëndë ushqyese jetësore, biopasurimit dhe programeve të sigurimit të ushqimit të bashkësisë. Mjerisht, në botën e zhvilluar ne nuk dëgjojmë shumë në lidhje me këto zgjidhje – madje as për këtë sfidë. Kur ne përqëndrohemi te uria, ne shpesh e shohim atë përmes lenteve të gabuara. Ne jemi shqetësuar gjatë në lidhje me nivelet masive të urisë së ardhshme: më 1968, Pol Erlih (Paul Ehrlich) deklaroi se njerëzimi e kishte humbur tashmë betejën për të ushqyer vetveten. Parashikimi i tij për urinë e ardhshme masive ishte bazuar në idenë themelore se një numër më i madh njerëzish nënkupton pashmangësisht më pak ushqim për secilin individ. Ç'është e vërteta, popullsia e botës është dyfishuar që nga viti 1961, por prodhimi i ushqimit pothuajse është trefishuar. Popullsia e botës në zhvillim ka kaluar pak më shumë se dyfishi, ndërsa prodhimi i ushqimit atje është katërfishuar. Rezultati ka qenë rritje me shpejtësi e kalorive të mundshme, sidomos në vendet në zhvillim. Që prej vitit 1950, përqindja e njerëzve që vuajnë nga uria është ulur vijimisht nga më shumë se 50% e popullsisë së botës në më pak se 18% sot. Në planet më afatgjata të OKB-së parashikohet që kjo përqindje të bjerë në mënyrë të vijueshme drejt 2,9% më 2050. Kjo do të përfaqësojë ende 290 milionë njerëz të kequshqyer në atë kohë. Në disa hulumtime të përmasave të mëdha, ku është vëzhguar ndikimi i ndryshimeve klimatike në prodhimin bujqësor dhe në sistemin e tregtisë ushqimore globale, përfshihen katër gjetje të rëndësishme të përgjithshme. Së pari, ato parashikojnë një rritje të madhe në prodhimin bujqësor – më shumë se një dyfishim të prodhimit të drithërave gjatë shekullit të ardhshëm. Sipas fjalëve të një ekipi modelimi: "Në përgjithësi, toka dhe burimet bujqësore, së bashku me përparimin teknologjik, duken të jenë të mjaftueshme për të ushqyer një popullsi botërore prej rreth 9 miliardë njerëz më 2080". Së dyti, ndikimi i ngrohjes globale në prodhimin bujqësor ndoshta do të jetë pengues, por në tërësi shumë i paktë. Gjedhet më ndjellakeqe, duke u përgatitur për ndikimet më ndjellakeqe klimatike, parashikojnë një ulje tërësore të prodhimit bujqësor prej 1,4% në krahasim me një variant pa ndonjë ndryshim të klimës. Gjedhja më ndjellamirë parashikon një rritje



neto të prodhimit bujqësor nga ngrohja globale prej 1.7%. Po të vendosen këto shifra në perspektivë, norma mesatare e rritjes në bujqësi gjatë 30 viteve të fundit ishte rreth 1.7%. Së treti, ndërsa në shkallë botërore do të ketë pak ndryshim, kjo nuk është e njëmendtë për nivelin rajonal. Në terma të përgjithshme, ngrohja globale ka një ndikim negativ në bujqësinë e vendeve në zhvillimin, por një ndikim pozitiv në bujqësinë e vendeve të zhvilluara. Ky realitet i ashpër është i lidhur me rritjen e temperaturës, e cila është e dobishme për bujqit në gjerësi të larta gjeografike (duke sjellë tejzgjatje të stinëve, të lashta të shumta dhe rendimente më të larta), por që nënkupton prodhueshmëri më të ulët për ata në vende tropikale. Në rastin më të keq, kjo do të thotë një rënie 7% e rendimentit në vendet në zhvillim dhe një rritje 3% në botën e zhvilluar. Kjo është një çështje që duhet ta shqyrtojmë, por ne gjithashtu duhet të kemi parasysh edhe tablonë më të gjerë: prodhimi i përgjithshëm edhe në vendet më pak të zhvilluara pritet të rritet rreth 270%. Gjatë shekullit të ardhshëm, vendet në zhvillim do të bëhen pashmangësisht më të varura prej importeve të ushqimit nga vendet e zhvilluara. Para së gjithash, kjo nuk është një dukuri e ngrohjes globale: edhe pa ngrohje globale, importet për vendet më pak të zhvilluara do të dyfishoheshin gjatë shekullit për shkak të demografisë. Ngrohja globale shkakton rritjen e importit nga rreth 100% në 110-140%. Ne duhet të mbajmë parasysh se më 2080, konsumatorët e vendeve në zhvillim do të jenë mjaft më mirë nga sa janë sot. Në një nga pikat e ekipit të modelimit vihet në dukje se konsumatorët e ardhshëm të vendeve në zhvillimin "do të jenë përgjithësisht të shkëputur nga proceset e prodhimit bujqësor, duke jetuar në qytete dhe duke siguruar të ardhura në sektorin jobujqësor. Ashtu si në vendet e zhvilluara të kohës së sotme, nivelet e konsumit varen kryesisht nga çmimet e ushqimit dhe të ardhurat në vend, sesa nga ndryshimet e prodhimit bujqësor vendas". Së katërti, në përgjithësi, në rastin më të gjasshëm, ngrohja globale do të jetë shkaktare për deri në 28 milionë njerëz më shumë të kequshqyer. (Në raste të tjera parashikohen ndikime më të ulëta të ngrohjes globale duke shkaktuar një zvogëlim tërësor të numrit prej 28 milionësh të njerëzve të kequshqyer). Është e rëndësishme për ta përfshirë këtë në kontekst. Bota sot ka rreth 925 milionë të kequshqyer. Gjatë shekullit të ardhshëm do të shtohen të paktën 2-3 miliardë njerëz më shumë, por megjithatë, ka të ngjarë që nga fundi i shekullit do të jenë "vetëm" rreth 108 milionë njerëz të uritur. Shkalla e përhapjes së urisë varet më pak nga klima dhe më shumë nga ekonomia. Madje edhe sikur të mbikëqyrej plotësisht ngrohja globale (përfytyroni që në njëfarë mënyre kemi ndalur shkarkimet e gazeve sot), do të shmangnim maksimalisht 28 milionë njerëz nga të qenët

> *Nëpërmjet pasurimit të artikujve bazë ushqimorë (me të tillë si hekur), zhvillimit të kulturave bujqësore më ushqyese dhe sigurimit të një shpërndarjeje më të gjerë të mikroushqyesve joorganikë, ne mund të merremi shumë më mirë me problemin shpesh të papërfillur të kequshqyerjes. Programet e sigurimit të ushqimit të bashkësisë mund të ndihmojë për të mundësuar përmirësime të qëndrueshme prej të cilave përfitojnë familje dhe gjithë bashkësia për një afat të gjatë kohor.*

të uritur deri në fund të shekullit. Për krahasim, nëse ia dalim mbanë për të lëvizur nga një prej planeve të veprimit të OKB-së më pak të dobishëm ekonomikisht drejt një tjetri më të dobishëm, ne do të mund të shmangnim 1.065 milionë njerëz të uritur deri në fund të shekullit. Sigurisht, është krejtësisht e pazbatueshme të mendohet që ne do të mund të ndalonim tërësisht ngrohjen globale ose aspektet ekonomike të urisë. Por ajo që duhet të përpiqemi për të bërë është të parashikojmë një plan veprimi që na jep numrin më të vogël të mundshëm të njerëzve të uritur – dhe kjo është e lidhur me rritjen sa më të lartë të të ardhurave. Përdorimi i politikës së klimës për të përftuar një ulje të vogël nuk është thjesht një strategji e shëndoshë ose etike. Pakësimet e shkarkimeve të karbonit krijojnë një ndryshim të vogël, të largët në ngritjen e temperaturës. Nëse Protokolli i Kiotos do të ishte zbatuar plotësisht, kequshqyerja do të ishte ulur me vetëm 2 milionë njerëz më 2080, me një kosto vjetore prej 180 miliardë dollarësh. Megjithatë, nëse shqetësohemi me të vërtetë për të ndihmuar të uriturit, ne mund të bëjmë shumë më tepër. Pikërisht këtu janë të nevojshme përgjigjet e thjeshta dhe të frytshme. Grupi i ekspertëve fitues të Çmimit Nobel që, në projektin e 2008-s të Qendrës së Konsensusit të Kopenhagës, rekomandoi investim më të madh për shtimin e mikroushqyesve joorganikë, pasurimin me lëndë ushqyese jetësore, biopasurimin dhe për programet e sigurimit të ushqimit të bashkësisë, e bëri këtë sepse edhe investime të vogla në këto fusha mund të sjellin një ndryshim të ndjeshëm. Nëpërmjet pasurimit të artikujve bazë ushqimorë (me të tillë si hekur), zhvillimit të kulturave bujqësore më ushqyese dhe sigurimit të një shpërndarjeje më të gjerë të mikroushqyesve joorganikë, ne mund të merremi shumë më mirë me problemin shpesh të papërfillur të kequshqyerjes. Programet e sigurimit të ushqimit të bashkësisë mund të ndihmojë për të mundësuar përmirësime të qëndrueshme prej të cilave përfitojnë familje dhe gjithë bashkësia për një afat të gjatë kohor. (Për hulumtimin që mbështet këto rekomandime, shih: www.copenhagenconsensus.com)

Investime të tjera tepër të vlefshme nga grupi i ekspertëve fitues të Çmimit Nobel, të tilla si zgjerimi i vaksinimit dhe mbulimi me barna kundër parazitëve, përmirësimi i parandalimit dhe i kurimit të malaries dhe ulja e kufizimeve për shkollimin e vajzave, do të ndikonin për ndryshime afatgjata që do t'i shndërronin bashkësitë më të rrezikuara në botë në më të fuqishme dhe më të zhdërvjellëta. Nëse ne përkujdesemi për të ndihmuar pjesën më të madhe të njerëzve që të shpëtojnë nga uria, atëherë duhet të pranojmë se shkalla e përhapjes së urisë varet shumë pak nga klima dhe shumë më tepër nga ekonomia.

**Bjorn Lomborg është autor i "Ambientalisti dyshimtar dhe këndvështrimi i ri", drejtor i Qendrës së Konsensusit të Kopenhagës dhe asistent profesor në Shkollën Tregtare të Kopenhagës.*

Tërheqja ushtarake nga Afganistani

MIMOZA GOLIKJA

Presidenti Obama në West Point, shpalosi planin e politikës së jashtme për vitet e tij të fundit (dy vjet e gjysmë) në detyrë. Trupat e SHBA do të largohen nga Afganistani deri në fund të vitit 2016. Në fjalimin e tij në Akademinë Ushtarake të Shteteve të Bashkuara, konfirmoi se të gjitha aktivitetet luftarake të trupave amerikane në Afganistan do të përfundojnë në fund të vitit 2014, kur do të mbeten 9800 ushtarë. Në fund të vitit 2015 numri i ushtarëve amerikanë në Afganistan do të reduktohet më tej në rreth 4900 trupa, deri sa në vitin 2016 prania ushtarake amerikane do të jetë e kufizuar në sigurinë normale rreth ambasadës dhe misioneve diplomatike të Shteteve të Bashkuara. Presidenti Obama e quajti këtë vit të një rëndësie të madhe, i cili do të shënojë fundin e misionit luftarak. "Angazhimi i Amerikës për popullin e Afganistanit do të qëndrojë ", tha Obama në fjalimin në "Bagram Air Force Base", ne do të vazhdojmë të qëndrojmë me afganët, që ata të forcojnë institucionet e tyre, që ata të ndërtojnë ekonominë e tyre, duke përmirësuar jetën e tyre". Nga ana tjetër Lirimi i rreshterit Bergdahl (i cili u gradua në robëri) ka krijuar probleme politike për administratën Obama, që po mbron këtë shkëmbim me pesë të burgosurit talebanë që mbaheshin në Guantanamo Bay, në Kubë, si dhe paraqet politikën delikate për republikanët të cilët janë kritikë ndaj ngjarjes me të burgosurin e fundit të njohur të luftës të Amerikës.

Administrata Obama argumenton se nuk ka shkelur ligjin

Më 3 qershor në Varshavë, presidenti Obama mbrojti shkëmbimin për lirimin e ushtarit amerikan në Afganistan. Duke iu përgjigjur kritikave të shkëmbimit për herë të parë. presidenti Obama tha para gazetarëve se kishte vendosur të mos njoftojë Kongresin paraprakisht siç kërkohet me ligj, sepse nuk kishte kohë të mjaftueshme. "Shtetet e Bashkuara kanë pasur gjithmonë një rregull shumë të shenjtë, e ky është: ne nuk i lëmë prapa burrat ose gratë tona në uniformë." I pyetur për rrethanat e kapjes së rreshterit Bergdahl nga ana e talebanëve, presidenti Obama tha se askush nuk e kishte marrë në pyetje atë dhe ende nuk ka ndryshuar përgjegjësia në përpjekje për ta rimarrë. "Ne jemi konsultuar me Kongresin për shumë kohë në lidhje me nevojën që mund të kishim në lidhje me mundësinë për të ekzekutuar një shkëmbim të të burgosurve në mënyrë që të mbulonte rreshter Bergdahl, tha ai, ne pamë një mundësi. Ne ishim të shqetësuar për shëndetin e rreshterit Bergdahl." Presidenti ka shtuar se "këto janë zgjedhje që vijnë në fund të luftës. Kjo është ajo që ka ndodhur me George Washingtonin, kjo është ajo që ka ndodhur me Lincoln. Kjo është ajo që ka ndodhur me FDR". Ai ka siguruar se pesë talebanët e dërguar në Katar në këmbim të rreshterit Bergdahl do të monitorohen. "Ne do të jemi duke mbajtur sytë mbi ta. A ekziston mundësia që disa prej tyre të përpiqen që të kryejnë aktivitete që janë të dëmshme për ne? Absolutisht. Unë nuk do të bëja këtë në qoftë se kjo do të ishte në kundërshtim me sigurinë kombëtare amerikane." Gjenerali Martin E. Dempsey, Kryetari i Shefave të Përbashkët të Shtabit, ka shkruar në faqen e tij në Facebook, "Kjo do ishte mundësia e fundit më e mirë për ta liruar. Sa për rrethanat e kapjes së tij, kur ai të jetë në gjendje do të mësojmë faktet. Ashtu si çdo amerikan, ai është i pafajshëm derisa të provohet se është fajtor. Ndërkohë ne do të vazhdojmë të kujdesemi për të dhe familjen e tij". Postimi në Facebook i gjeneralit Dempsey, është tregues i fortë se Departamenti i Mbrojtjes mund të ndjekë një lloj veprimi ndëshkues për rreshterin Bergdahl. Në një intervistë me "Associated Press" të martën, Gjeneral Dempsey pohon se promovimi i ardhshëm i Bergdahl për rreshter stafi, nuk do të ndodhë automatikisht, sepse rreshteri ka munguar për një kohë të gjatë. Që prej lirimit Bergdahl, administrata është përballur me pyetje mbi vendimin e tij për të liruar pesë të burgosur të Guantanamos dhe për mos njoftimin e Kongresit 30 ditë më parë, siç kërkohet nga ligji. Administrata Obama argumenton se nuk ka shkelur ligjin duke mos arritur të sigurojë njoftimin në Kongres. Ajo e ka cilësuar këtë si një veprim të detyruar për të lëvizur shpejt, për shkak të një mundësie të afërt, si dhe fleksibilitetit i dhënë nga nënshkrimi i deklaratës nga presidenti vitin e kaluar ku njoftimi ishte një shkelje jo kushtetues në kompetencat e tij.

Bergdahl mund të përballet me dënimin për braktisjen e njësisë së tij në Afganistan

Pak pas mesnatës kur sapo kishte hyrë data 30 qershor i vitit 2009, Bowe Bergdahl kishte lënë një shënim në çadrën e tij ku kishte shkruar se ai ishte zhgënjyer me ushtrinë, nuk e mbështeste misionin amerikan në Afganistan dhe po largohej për të filluar një jetë të re. Ai u largua nga posta e largët ushtarake në "Paktika Provinca" në kufi me Pakistanin duke marrë me vete çantën e shpinës në të cilën kishte ujë, thikë, fletore dhe laps, por la pa marrë pajimet dhe armët, befasuese kjo duke pasur parasysh mjedisin armiqësor rreth tij. Sipas një ish oficeri të lartë, kjo është pjesë e një pamje më të komplikuar në zhvillimin e kapjes së një ushtari i cili u mbajt pesë vjet si i burgosur nga talebanët, ndikoi negociatat e nivelit të lartë diplomatik dhe ngjarja përfundoi me një lëvizje të shpejtë të helikopterit të komandove amerikane. Kritikët thonë se kërkimi i furishëm për rreshterin Bergdahl duke përdorur avionë të telekomnduar "Predator", helikopterë sulmi Apache dhe qen të ndjekjes ushtarake, çoi në vdekjen e së paku dy ushtarëve dhe ndoshta gjashtë të tjerëve në zonë. Mirëpo zyrtarët e Pentagonit pohojnë se rishikimi dhe përmbledhja e bazës së të dhënave të viktimave në luftës në Afganistan, tregojnë se këto akuza janë të pabazuara dhe nuk janë të mbështetura dhe se kritikët e rreshterit Bergdahl nuk kanë të drejtë kur fajësojnë atë për çdo ushtar amerikan të vrarë në "Paktika Provinca" në periudhën katër mujore që pasoi zhdukjen e tij. E megjithatë ish komandanti Cornelison thotë se rreshteri Bergdahl tani që është kthyer, duhet të mbajë përgjegjësi. "Ai duhet të bëhet 100 përqind i përgjegjshëm për 29 personat e tjerë në togën time përfshi edhe mua, që kaluam në ferr për 90 ditë." Thuhet se rreshter Bergdahl u largua nga posta e tij, ndoshta në këmbë, por mundësia është që edhe të jetë fshehur në automjetin e një kontraktori. Sipas ish oficerit "Ai nuk ka dalë nga porta e cila ishte pikë kontrolli dhe nuk ka asnjë provë që ka shkelur telat rrethues". Pjesëtarët e togës, kanë thënë se rreshter Bergdahl, ishte i njohur si i dhënë pas librave dhe i mbushur me nocione romantike. Ai nuk pinte birrë apo nuk hante si 20 vjeçarët e tjerë barbecue, ishte gjithmonë në krevatin e tij marinar, duke ushtruar të mësuarit e gjuhëve si dari, arabisht dhe pashto. Madje është thënë se rreshteri Bergdahl shkroi romane të tipit "Jason Bourne" në të cilën ai ka futur veten si karakterin kryesor. Midis kritikave në rritje në lidhje me operacionin, krerët e lartë ushtarakë iu janë përgjigjur kritikave drejt Bergdahl, në deklaratat, si gjeneralit Dempsey ashtu dhe të John McHugh, lihet e hapur mundësia që ushtari i ri do të mund të përballet me një qortim të këtij lloji. "Nuk ka asnjë afat kohor për këtë, dhe ne do të marrim aq kohë sa është e nevojshme që mjekësia të ndihmojë në shërimin e tij." Të gjitha vendimet e tjera do të bëhen më pas, dhe në përputhje me rregulloret përkatëse të politikave dhe praktikave."

Shtëpia e Bardhë, shkëmbimi i të burgosurve u diskutua që në vitin 2011

Kornizat e shkëmbimit të propozuar për Bergdahl kishin qenë publike që nga pranvera e vitit 2012 për disa agjensi të lajmeve, por lajmi nuk u publikua me kërkesë të Pentagonit, i cili argumentoi se deklarimi publik se Bergdahl ishte subjekt i një marrëveshje midis talebanëve dhe Shteteve të Bashkuara mund të vinte në rrezik jetën e tij. Megjithatë zyrtarët e administratës Obama kishin diskutuar së pari me republikanët për mundësinë e shkëmbimit të pesë të ndaluarve për terrorizëm në gjirin e Guantanamos, Kubë, në këmbim të lirimit të rreshterit Bowe Bergdahl në fund të nëntorit të vitit 2011, sipas ndihmësve të lartë GOP. Shkëmbimi i mundur i të burgosurve u diskutua përsëri gjatë një konferencë në 31 janar 2012. Qeveria amerikane, sipas një ish zyrtari amerikan, pati inteligjencë të fortë mbi vendndodhjen e rreshterit Bowe Bergdahl pas ai u zhduk në vitin 2009, por në fund vendosi se misioni i shpëtimit ishte shumë i rrezikshëm. Zyrtarët amerikanë kanë qenë në gjendje të identifikojnë shtëpi të sigurta në zonën rreth Miran Shah ku u mbajt Bergdahl dhe kanë dërguar informatorë në rajon në përpjekje për të mbledhur informacion. E megjithatë marrja në konsideratë e një operacioni ushtarak për të shpëtuar Bergdahl u refuzua për shkak të do të kishte rezultuar në një numër të madh të viktimave të SHBA. Për të gjetur vendndodhjen Bergdahl, Shtetet e Bashkuara dislokuan burime të mëdha, duke përfshirë informatorët, satelitët dhe avionë të telekomanduar sipas zyrtarëve. Por rrëmbyesit e tij e fshehën atë edhe nën veshjen tradicionale. Zyrtarët amerikanë të zbulimit mësuan kohët e fundit se shëndeti i ushtarit ishte përkeqësuar. Sekretari i Mbrojtjes Chuck Hagel citoi problemet shëndetësore të paspecifikuara Bergdahl si një faktor në vendimin për të shkëmbyer atë me pesë të burgosurit në Guantanamo. Mirëpo lirimi i të burgosurit të fundit amerikan i luftës në Afganistan ka rihapur misterin se si ai u kap dhe nëse ai është një patriot apo një dezertor. Edhe pse rreshter Bowe Bergdahl arrin në shtëpi në SHBA, pas gati pesë vjet në robëri, ushtarët, veteranët, deri edhe mediat sociale janë përfshirë me komente ku denoncojnë ish të burgosurin për "braktisjen" e njësisë së tij. Ende nuk janë përshkruar rrethanat e zhdukjes Bergdahl ose kapjen e tij nga ana e terroristëve. Madje në internet një peticion që ka më shumë se 5.600 nënshkrime dixhitale i bën thirrje administratës Obama për të ndëshkuar Bergdahl duke thënë se ka precedentë të mjaftueshëm për Bergdahl. "Ai është në të mirë të një dezertor dhe në të keqe tradhtar". Kolonel Steve Warren, zëdhënës i Pentagonit u tha gazetarëve se Ushtria ka prodhuar më parë një raport mbi rrethanat e zhdukjes Bergdahl, i cili mbetet i klasifikuar. Lirimi i pesë të burgosurve talebanë në këmbim të një ushtari amerikan nuk ka mbetur pa kritika edhe prej afganëve, të cilët thonë se të burgosurit janë të rrezikshëm dhe do të rindizen lidhjet me rrjetet terroriste për të rifilluar luftën, kur shumica e trupave të huaja të largohen. Të burgosurit janë klasifikuar nga Pentagoni si me "rrezik të lartë" dhe "ka gjasa të përbëjnë një kërcënim". Madje dy prej tyre janë implikuar edhe në vrasjen e mijëra myslimanëve të pakicave shiite në Afganistan. Frika se të burgosurit do të kthehen në betejë i bën talebanët dyshues se shkëmbimi do të shërbejë si një gjest i vullnetit të mirë apo një hap drejt ringjalljes së bisedimeve të paqes midis kryengritësve islamikë dhe qeverisë afgane, aq më tepër në ndihmë të procesit të paqes.

Afganistani në "Lojën e Madhe"

Trupat e huaja patrullojnë Afganistanin, vendin që ka tërhequr në forcat ushtarake nga një numër shtetesh të botës. Ai ishte në qendër të të ashtuquajturës "Lojës së Madhe " që në shekullin e 19-të, si një shtet tampon në konkurrencën për ndikim të Perandorisë Ruse dhe Britanisë në Indi. Gjatë Luftës së Ftohtë, mijëra trupa sovjetike ndërhynë në vitin 1979 për të mbështetur regjimin pro komunist, kjo u pasua nga lufta civile e viteve 1990, ngritja dhe rënia e qeverisë ekstremiste talebane. Lufta u bë prezent në vitin 2001. Afganistani ka qenë i shkatërruar nga konflikti për dekada të tëra. Shfaqja e talebanëve, fillimisht si një grup i dijetarëve islamë, solli të paktën një shkallë stabiliteti pas gati dy dekadave të konfliktit. Tri dekada më pas Afganistani u bë një nga vendet më të rrezikshme në botë. Por për versionin e tyre ekstrem të islamit ka kritika të shumta. Në kontrollin e rreth 90 % të Afganistanit deri në fund të vitit 2001, talebanët u njohën si qeveri legjitime vetëm nga tre shtete. Ata kanë qenë në mosmarrëveshje me komunitetin ndërkombëtar mbi praninë e Osama bin Laden në tokat e tyre, i cili urdhëroi bombardimin e ambasadave amerikane në Afrikë në vitin 1998 dhe sulmet në SHBA në 11 shtator 2001. Në shtator të vitit 2001 pas sulmeve të datës 11, Presidenti George W. Bush iu dha talebanëve ultimatumin për dorëzimin e Bin Laden, por ata refuzuan. Pas refuzimit SHBA filloi sulmet ajrore në tetor 2001, duke hapur rrugën për grupet opozitare dhe një pranie ushtarake afatgjatë e udhëhequr nga NATO. Në dhjetor të vitit 2001, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara autorizoi krijimin e Forcës së Ndihmës për Sigurinë Ndërkombëtare (ISAF) për të ndihmuar në ruajtjen e sigurisë në Afganistan dhe për të ndihmuar administratën e Karzait. Në vitin 2002 Hamid Karzai u bë president i përkohshëm i Afganistanit dhe talibanët vazhduan të zhvillonin luftën guerile pranë kufirit me Pakistanin. Në vitin 2004, ratifikohet Kushtetuta e re duke e bërë Afganistan një shtet islamik me një president të fortë. Më vonë presidenti i përkohshëm Karzai fitoi zgjedhjet e para presidenciale të vendit. Ishte shkurti i vitit 2009 kur presidenti Obama urdhëron 17.000 trupa shtesë në Afganistan dhe në gusht po të vitit 2009, presidenti Karzai fitoi rizgjedhjen në një votim të njollosur nga mashtrimi. Në dhjetor 2009 presidenti Obama urdhëroi dërgimin e 30000 trupave dhe në vitin 2010 duke e çuar forcën e përgjithshëm amerikan në rreth 100000. Në vitin 2012 që ishte dhe viti i 11-të konfliktit, NATO mbështeti planet për t'ia transferuar detyrat luftarake forcave afgane deri në mes të vitit 2013. Rreth 130000 trupa luftarake të udhëhequr nga NATO do të largohen nga Afganistani deri në dhjetor 2014. Aleanca thotë se është e angazhuar për një marrëdhënie afatgjatë strategjik me Afganistanin përtej kësaj date. Ndërkohë, hapa tentativë drejt një marrëveshje të negociuar të paqes kanë filluar në vitin 2012, kur talebanët njoftuan se kishin rënë dakord për të hapur një zyrë në Dubai për bisedime me zyrtarë amerikanë.

"Mësimet e Nxjerra" nga misionet "EAGLE 1-7"

Sugjerime për zbulimin, vëzhgimin dhe për njohjen e FS

Kolonel Dritan Demiraj*

Përderisa rebelët përdorin zonat e mëparshme të suksesshme të pritave dhe të mjeteve shpërthyese të improvizuara (MSHI), drejtuesit duhet të kryejnë me kujdes zbulimin, vëzhgimin dhe përnjohjen e zonës së tyre të operacionit. Ata duhet të kenë harta ose makete të terrenit që tregojnë vendet e mëparshme të pritave dhe të mjeteve shpërthyese të improvizuara për një periudhë jo më pak se një vit. Të preferueshme janë të dhënat historike për më tepër se një vit. Zakonisht ata përdorin vende pritash kundër forcave të koalicionit, të cilat i kanë përdorur kundër forcave sovjetike gjatë operacioneve të tyre në Afganistan siç theksova dhe më lart. Seksionet e zbulimit të kontingjenteve tona, brigadës/batalionit amerikan dhe nënreparteve të tjera të ISAF-it, duhet të grumbullojnë një listë reference të plotë të zonave të pritave dhe MSHI-ve për zonën e tyre të operacionit. Anëtarët e patrullës duhet të njohin zonat e pritave dhe të mjeteve shpërthyese të improvizuara në rrugëkalimin e tyre të patrullimit. Asetet e zbulimit, vëzhgimit, përnjohjes, duhet të koordinohen për rrugëkalimin e patrullës përpara çdo patrulle, duke i kushtuar vëmendje të veçantë për zonat e pritave dhe të MSHI-ve të mëparshme apo të mundshme. Ajo që unë kam pasur parasysh personalisht gjatë dislokimit dhe që nuk e kam neglizhuar kurrë si drejtues i misioneve luftarake në Afganistan, ka qenë studimi me shumë kujdes i zonave nga kalonin makinat tona, pasi ato ishin të pablinduara dhe gabimi më i vogël kushtonte humbjen e të paktën 5 operatorëve. Ngritja e rrjetit të informacionit dhe shfrytëzimi në maksimum i informacionit në zonën ku vepronim, duke marrë telefonata nga agjentët tanë direkt në terren, se ku një natë më parë talebanët kishin vendosur minat surprizë, e rriti ndjeshëm sigurinë tonë. Në të gjitha rastet, jo vetëm vinim në dijeni palën amerikane për vendndodhjen e tyre por dhe studionin me vëmendje teknikën e përdorur nga terroristët gjatë vendosjes së tyre. Kishte raste të cilat ato viheshin në përdorim me telekomandë nga distanca të konsiderueshme me celular, pastaj më vonë pasi filloi përdorimi i Jammers kryesisht me shtypje, zgjatja e linjës së ngarkesës së parë e cila ishte më e dobët se ngarkesa e dytë dhe kur kalonte "mine rollers" ajo nuk plaste, kur kalonte mjeti dhe kur goma shkelte mbi të (ngarkesën) ngarkesa shpërthente dhe e bënte mjetin copë-copë. Pas vitit 2013 filluan të përdornin ngarkesa eksplozive të infektuara me mikrobin e SIDA-s, më pas duke përdorur mina të vëna në veprim në mënyrë magnetike, ku vendosja e tyre afër dyerve të shtëpive bënte të mundur shpërthimin kur patrullat kalonin midis tyre. Një taktikë tjetër ishte dhe vendosja e eksplozivave sipër mureve, që në rast se hipnin mbi mur për tu futur në ndonjë kompleks banimi trupat e koalicionit, ajo shpërthente dhe i dëmtonte. Përveç këtyre talebanët vendosnin mjete shpërthyese në të gjitha vendet që ata mendonin se mund ti shfrytëzonin kundër forcave tona. Brenda dhomave në pragun e derës, sidomos në vendet ku ata kishin "punishtet" për prodhimin e bombave artizanale, të lidhura me armë dhe sende të tjera që tërhiqnin vëmendjen. Minonin të gjitha rrugët

që të çonin drejt këtyre objekteve dhe i markonin me shenjë që i dinin vetëm vetë, të cilat jua tregonin dhe fëmijëve. Për t'ju shmangur këtyre TTP-ve ne filluam për herë të parë duke mos përdorur kurrë hyrjen nga dyert ose në oborret e objekteve që kishim në kërkim, por nga ana e jashtme e banesave (ana e jashtme e mureve) duke bërë hapjen me eksploziv dhe futjen brenda, duke krijuar kështu elementin surprizë dhe duke mos i dhënë kohë terroristëve, të reagonin kundër nesh. Gjithashtu një pikë shumë e rëndësishme që na çoi drejt suksesit, ishte "skanimi dhe kontrolli i imtësishëm" që i bënim rrugëve mbi të cilat ecnim dhe bashkëpunimi me fshatarët e zonave ku vepronim nëpërmjet informatorëve tanë.

Stërvitu, kupto dhe praktiko kundër-rebelimin!

Në Manualin e Luftimit FM 3-24.2 të ushtrisë amerikane, "Taktikat në kundër-rebelim" (Tactics in Counter-insurgency) citohet: "Patrullimi energjik në një zonë u zvogëlon rebelëve lirinë e lëvizjes, prish operacionet, dobëson ndikimin e tyre në popullsinë lokale". Ushtarët, në interes të kryerjes së detyrave, dalin dhe lëvizin nëpër popull. Ata duhet ta dinë dhe njohin çfarë duket normale në zonën e tyre të patrullimit. Ky rebelim që po ndodh në Afganistan është rebelim rural. Ushtarakët në Jug të Afganistanit kalojnë një pjesë të mirë të kohës duke patrulluar në terren. Grupet e ndryshme kryejnë zakonisht tre herë në javë patrullime, dy deri tre ditë, duke ndryshuar oraret e patrullimit për të mos vendosur gjëra shabllone sidomos në drejtim të zgjedhjes së rrugëkalimeve për t'iu shmangur vendosjes së minave. Gjatë kohës që ata janë duke "vrapuar ose luftuar" në të njëjtën kohë marrin pjesë dhe në mbledhjet shura, (termi islamik i takimeve) pinë çaj, hanë mish dhie së bashku me liderët e komuniteteve, etj.

Afganët kanë qenë historikisht një shoqëri realiste, e ndjeshme dhe praktike. Ata nuk do ta kenë të lehtë që të zgjedhin se me cilin krah do të partnerizohen, derisa të jenë të qartë se cili krah do të jetë fituesi, rebelët apo forcat e koalicionit. Afganëve nuk iu bën përshtypje rritja e sasisë së forcave. Ata shohin vetëm veprat dhe jo premtimet dhe janë shumë materialistë. Ndërtimi i një fryme besimi me popullsinë lokale, bën që më tepër njerëz të tregojnë vendet e vendosjes së minave surprizë dhe të japin informacion për rrjetet lokale të ndërtimit të tyre. Afganët gjithashtu shqetësohen për sigurinë e familjeve të tyre. Mbas 30 vjet luftërash të dhunshme, tendenca e afganëve është të besojnë tek cilido që ofron siguri, pavarësisht nëse është taleban, forcë koalicioni apo Qeveri e Republikës Islamike të Afganistanit.

FS shqiptare dhe amerikane në Jug të Afganistanit kanë arritur një sukses të dallueshëm nëpërmjet parimeve të zbatuara mirë të kundër-rebelimit. Parimi i tyre i operimit është që çdo operator është një kundër-rebelues, secili kupton dhe praktikon kundër-rebelimin. Një pjesë e mirë e gjetjes dhe e zbulimit të MSHI-ve vjen nga popullsia lokale. Kjo ka ardhur kryesisht për shkak të respektit të fituar duke ofruar siguri te popullsia, duke zbatuar projekte të ndryshme në ndihmë të tyre, duke dhënë materiale për shkollat, mbledhjet e tokave të tyre, duke siguruar ndihmë të shpejtë, etj. Ndërsa numri i MSHI të vendosura në Afganistan është rritur dukshëm vitet e fundit si pasojë e kësaj është rritur dhe numri i të vrarëve nga forcat e koalicionit, përqindja e MSHI të gjetura nga popullsia lokale është rritur atje ku forcat e koalicionit kryejnë operacione të mira kundër-rebelimit dhe kanë bashkëpunim të mirë (si në rastin tonë në qytetin e Spin Buldokut ku që kur FS tona morën qytetin nën kontroll, siguria është rritur rreth 300%). Patrullimet me këmbë, një nga karakteristikat kryesore të veprimit nga efektivat e kontingjenteve "Eagle", raportojnë një numër më të madh të MSHI-ve të gjetura dhe pastruara në krahasim me patrullimet me mjete (kjo nuk përfshin patrullimet e mjeteve të pastrimit të rrugëve EOD).

Shfrytëzo gabimet e rebelëve!

Trupat e koalicionit duhet të shfrytëzojnë gabimet e rebelëve duke vepruar si më poshtë vijon:

- Të shfrytëzojnë në favor të tyre mosmarrëveshjet, diferencat dhe ndarjet fisnore ndërmjet udhëheqësve rebelë.
- Të përdorin informacionin e nxjerrë nga rebelët, për dëmet në të vrarë e të plagosur nga mjetet e shpërthimit, me qëllim që të jenë të parët për t'i komunikuar të vërtetën popullsisë lokale.

Stërvitja para daljes në detyrë

Stërvitja para daljes në detyrë gjykoj që është një faktor shumë i rëndësishëm për rritjen e aftësive të efektivit për të përballuar operacionin luftarak (betejën). Stërvitja e mirë para daljes në detyrë e ndihmon efektivin tuaj për të ripërsëritur detyrimet e secilit në rast se..... në postin e tij luftarak. Stërvitja para daljes në detyrë:

- Është mundësia për të kontrolluar aftësitë luftarake të secilit individ, grupit tuaj, n/repartit, etj.
- Është stërvitja e trurit për reagimin konkret në situata kritike për trupat që e kanë për herë të parë eksperiencën në luftime.
- Lejon efektivin të solidarizohet si ekip.

Në vijim do të mundohem të shpjegoj të gjithë elementët e stërvitjes para daljes në detyrë:

a) Drejtimi i njësive të vogla.

b) Kontrolli i imtësishëm i njohurive për detyrë, i pajisjeve dhe gatishmërisë së armatimit.

c) Operacionet në kushte të veçanta terreni dhe moti, operacionet në shpella.

d) Operacionet në lartësi të mëdha.

e) Operacionet në mot të ftohtë.

f) Veprimet mbi mjete të blinduara.

g) Reagimi ndaj mjeteve shpërthyese të improvizuara.

h) Reagimi ndaj sulmeve si prita ose sulme indirekte, etj.

Lidershipi i njësive të vogla

Drejtuesit dhe operatorët e FS janë të adaptueshëm dhe fleksibël, me një eksperiencë në shkallë të gjerë të aftësive, janë më të suksesshëm në një mjedis kundërrrebelues, që në Afganistan zhvillohet vazhdimisht. Komandantët kreativë kanë iniciativë, krijojnë e ndërtojnë marrëdhënie të mira me vendasit dhe janë të aftë të përshtatin operacionet me situatën lokale. Kryekapteri Hall, për eksperiencat e tij në aplikimin e COIN në Afganistan, shkruan: "Si lider, qëllimi juaj është që të bëni një emër të mirë për vete dhe njësinë tuaj në komunitet, ndërsa mbani në nivele të ulëta frikën, për t'u përballur me armikun. Liderët duhet të krijojnë drejtësi dhe besim nëpërmjet fjalëve të tyre, premtimeve dhe veprimeve". Ai jep konkluzionet e tij në lidershipin e njësisë së vogël në një përmbledhje të quajtur "Gjërat e mprehta që njerëzit kanë thënë ndërsa janë në Afganistan, pjesa I-rë (Smart Things People Have Sad While in Afganistan - part 1).

***Shef i Qendrës së Simulimit**

"Divizioni I-rë Sulmues", formacion luftarak partizan i shkallës operative

Dr. Asllan Zemani*
MSC. Alketa Gjoliku

Më 28 maj 1944 u krijua Divizioni I-rë sulmues i Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Kjo ngjarje e rëndësishme ndodhi vetëm pak kohë pas mbarimit të punimeve të Kongresit të Përmetit, i cili, në vendimet që mori, i kushtoi rëndësi të veçantë zgjerimit të mëtejshëm të luftës kundër pushtuesve fashiste dhe realizimi i të cilës kërkonte, veç të tjerave, forcat dhe formacionet e nevojshme të shkallës operativo-strategjike, që mund të realizonin operacione të këtyre përmasave. Formimi i këtij formacioni, të cilit i ra "barra, por edhe të printe në kryerjen e detyrës historike që, pasi të kalonte lumin Shkumbin, të hidhej në mësymjen e përgjithshme dhe të niste njëkohësisht edhe zbatimin e planit për krijimin e formacioneve të mëdha të UNÇSH-së", duke përcaktuar një etapë të re edhe në forcimin e mëtejshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Formacioni i këtij niveli dhe i këtyre përmasave në historinë e organizative ushtarake në vendin tonë është dukur qysh herët, "në periudhën e Pashallëqeve Shqiptare, të Janinës dhe ajo e Bushatllinjve të Shkodrës" e më pas në "fillimin e viteve njëzet-tridhjetë të shekullit XX, divizioni nisi të përdorej edhe në Ushtrinë Kombëtare të Fuqive te Armatosura (Armate) të Shqipërisë". Kjo njësi e madhe e shkallës operative përbëhej nga disa brigada, deri në tre të tilla por pati raste që u formuan edhe me katër brigada siç ishte Divizioni VI Sulmues e ndërsa sasia e forcave ndryshonte nga njeri tek tjetri formacion dhe varionte nga 3000 deri në 3300 luftëtarë.

Në atë kohë lufta e popullit tonë dhe e Ushtrisë së tij Nacionalçlirimtare kishte marrë një hov më të madh dhe Shtabi i Përgjithshëm, sipas direktivave të Komandantit të Përgjithshëm, shfrytëzoi me mjeshtri rrethanat objektive që ishin krijuar në arenën ndërkombëtare ku lufta e popujve antifashistë si dhe fitoret e përparimi i vrullshëm i trupave sovjetike nga Lindja në drejtim të Perëndimit por edhe sukseset që ato po arrinin në Ballkan. Formimi i Divizionit I Sulmues përbënte prologun e formimit të këtyre formacioneve, që do të vijonin me krijimin edhe të shtatë të tjerëve. Në këtë mënyrë kishte nisur praktikisht procesi i shndërrimit të UNÇSH-së në ushtri tërësisht të rregullt. Divizioni, si një njësi e shkallës së madhe, natyrisht që kishte një përbërje që mundësonte drejtimin dhe veprimtarinë e gjerë, të vazhdueshme e të suksesshme të brigadave sulmuese, numri i të cilave ishte rritur mjaft. Një gjetje e tillë në formën e organizimit të këtyre formacioneve të mëdha të Ushtrisë NÇ natyrisht ishte me vend, zgjidhja më e gjetur dhe e drejtë për kohën dhe nivelin ku kishte hyrë lufta. Kjo mënyrë e organizimit të divizionit vinte përshtat kushteve ekonomike e politike të vendit e të popullit shqiptar, si dhe kërkesave ushtarake që shtronin detyrat e reja luftarake në kuadrin e mësymjes së përgjithshme për çlirimin e vendit. Një organizim i tillë, njëkohësisht mbështetej në parimet e autonomisë, të manovrueshmërisë së lartë dhe të drejtimit të shpejtë, natyrisht me pak mjete teknike për ndërlidhjen që kishin këto formacione të mëdha dhe mbante parasysh natyrën tipike malore të vendit tonë, mundësitë për të mënjanuar e përballuar epërsinë e përhershëm që vazhdonin të ruanin pushtuesit në forca e mjete luftarake, zbatimin e taktikës së luftës partizane dhe të asaj ballore etj. Kështu, pas dështimit të Mësymjes së Dytë të Përgjithshme naziste të Qershorit 1944, Divizioni I Sulmues, duke e vënë në jetë urdhrin e Komandantit të Përgjithshëm të UNÇSH-së u hodh në mësymje të përgjithshme për çlirimin e Shqipërisë. Në fund të Qershorit të 1944 divizioni kaloi lumin Shkumbin dhe nisi operacionin, i cili përbënte fillimin e Mësymjes së Përgjithshme. Divizioni I Sulmues bashkëpunonte me forcat partizane vullnetare të zona-ve dhe qarqeve ku shtrinte veprimet e veta. Zhvillimi i veprimeve luftarake dhe përfundimi i tyre vuri në pah disa tregues domethënës për mundësitë e mëdha luftarake që përmbante ky formacion. Kalimi i Shkumbinit dhe mësymja në veri të tij u bë nga brigadat, të cilat mësynin së bashku në një brez me gjerësi 90km, thellësia e mësymjes arriti deri në 80 km. Në këtë mënyrë divizioni me brigadën e tij veproi në një sipërfaqe me përmasa 90-80km të barabarta me 7200km². Kohëzgjatja e operacionit u shtri në një hark kohor prej afro dy muajsh. Pagëzimin e tyre forcat e Divizionit të 1-rë e bënë në zjarrin e luftës. Që në ditët e para të formimit, sikundër gjithë forcave të tjera të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, atyre iu desh të përballonin operacionin armik të Qershorit në një zonë të ngushtë ndërmjet krahinave të Tomorricës, Sulovës e Mokrës. Luftimet e divizionit në këtë zonë përbëjnë fazën e parë të veprimtarisë së tij të shkëlqyer kundër nazistëve e bashkëpunëtorëve të tyre, të cilët u përpoqën ta rrethonin dhe ta asgjësonin. Armiku, duke e ndjerë peshën e rëndë të këtyre forcave partizane, u mundua të mos u jepte kohë që të kalonin në veprime mësymëse. Për sa i përket forcave të divizionit, ato ishin ngarkuar nga Komandanti i Përgjithshëm që të hidheshin dhe të vepronin në Shqipërinë e mesme dhe të veriut nëpërmjet urdhrit të datës 1 Qershor 1944, duke kërkuar nga forcat e divizionit që të goditnin pamëshirë armikun, rrugët e komunikacionit të tij, të likuidonin bashkëpunëtorët e tyre në zonat e Çermenikës, Zaranikës, rrethit të Tiranës, Matit e Dibrës dhe të organizonin në to pushtetin nacionalçlirimtar, të mobilizonin popullin për luftë dhe të mëkëmbnin njësitet partizane që ishin dëmtuar në luftimet e mëparshme. Operacionit mësymës plotësoi detyrat në tri faza. Në këtë mënyrë divizioni kishte mundësi të përqendronte forcat dhe të jepte goditje më të favorshme kundër armiqve dhe tradhtarëve që mbroheshin me shumë forca e mjete në një territor të thyer e shumë të thyer malor, si dhe për t'u përgatitur për mbrojtje. Por gjithsesi edhe gjatë këtyre fazave divizioni pati mundësi që me forcat dhe mjetet e veta të vepronte në sipërfaqe relativisht të gjëra. Kësisoj Divizioni I Sulmues në fazën e pare të mësymjes së tij (20.6-3.7.1944) veproi në një zonë me sipërfaqe 90 km të thellë, në fazën e dytë (3-28.7.1944) divizioni i shtriu veprimet luftarake në një sipërfaqe prej afro 3000 km², duke përballuar edhe një goditje të armikut me përbërje 8000 gjermano-reaksionarë. Kurse në fazën e tretë kur forcat e divizionit u desh të përballonin, krahas mësymjes edhe kundërgoditjen tjetër të armikut gjithashtu me 8000 forca, veprimet kapen një zonë prej 2000km Ndërsa në operacionin për çlirimin e kryeqytetit të vendit, Tiranës, krahas një sërë përmirësimesh në strukturën e brendshme organizative të brigadave e të batalioneve, në kompani lindi një hallkë e re e nevojshme organizative, togat. Kjo hallkë, tashmë jo vetëm bënte një degëzim më të natyrshëm dhe harmonik të kompanisë, por sidomos lehtësonte mjaft drejtimin e skuadrave dhe mundësonte veprimin sulmues të kompanisë në më shumë se një drejtim (rrugë, rrugica etj) në qytetet, ku kjo ishte një dukuri krejt e zakonshme. Ndërkohë pjesë përbërëse e batalioneve u dukën edhe skuadrat e zbulimit (informacionit) dhe ato të disiplinës. Detyrat e skuadrave të zbulimit në përgjithësi ishin të siguronin repartet dhe komandat e tyre nga agjentet armiq, të cilët duhej ti zbulonin, ti kapnin ose ti asgjësonin menjëherë, sipas rastit. Njëkohësisht partizanët e këtyre skuadrave duhet të kryenin edhe detyrën e ndërlidhjes mes shtabeve të batalioneve sulmuese, si gjatë luftimeve dhe gjatë pushimeve. Për këto arsye këtyre skuadrave iu bashkuan edhe lajmëtarët e batalioneve. Gjithashtu skuadrat e zbulimit kishin për detyrë që, duke vepruar me anë patrullash të vogla përpara dhe në krahë të reparteve të tyre, të mbikëqyrnin, të hetonin dhe të zbulonin çdo lidhje të armikut, kurdoherë në bashkëpunim me popullin dhe në radhë të parë me njerëzit e këshillave nacionalçlirimtare në terren etj. Pas kësaj ata vinin në dijeni shtabet përkatëse për çdo zbulim apo informatë lidhur me krijimin e skuadrave të disiplinës të batalioneve, komanda e korparmatës urdhëronte: "Të organizohen urgjentisht skuadrat e disiplinës...". Detyra kryesore e këtyre skuadrave ishte të ndihmonin komandat e shtabet e tyre për ruajtjen e rregullit, të qetësisë e të disiplinës nëpër qytetin ku veprohej. Duke analizuar veprimet luftarake të Divizionit të 1-rë në këtë etapë, mund të arrihet se "vendimi i Komandës së Përgjithshme për një manovër të gjerë të Divizionit të 1-rë, duke u futur thellë në dispozitivin e armikut dhe duke e goditur atë në bazat e tij më të forta, në rezervat e tij kryesor", pati një rëndësi historike. "Divizioni i 1-rë u rrethua tri herë nga forcat armike në qarkun e Dibrës, porse, duke përdorur manovrën dhe shpirtin sulmues si armë kryesore, ai mundi jo vetëm të dilte nga rrethimi, por në një kohë të shkurtër të shpartallonte të gjitha forcat e armikut dhe të çlironte të gjithë Shqipërinë e mesme dhe një pjesë të Shqipërisë së veriut". Pas këtyre veprimeve divizioni kreu detyra të reja. Pasi hyri në kuadrin e Korparmatës së l-rë, Brigada e 5-të veproi në Lumë. Ajo goditi autokolonat gjermane në rrugën Kukës-Prizren, çliroi Lumën, Hasin, etj. Brigada e I-rë çliroi Krujën me luftime të përgjakshme, sulmoi armikun në Prezë dhe se fundi hyri në Tiranë për çlirimin e kryeqytetit. Brigada e 4-të veproi në zonën e Elbasanit dhe u shkaktoi autokolonave gjermane humbje të rënda së fundi po ky formacion sulmoi armikun në Tiranë krahas me Brigadën e l-rë dhe brigadat e tjera të Ushtrisë Nacionalçlirimtare. Divizioni i l-rë sulmues e mbylli kapitullin e veprimtarisë së tij luftarake me fitoren e shkëlqyer të çlirimit të Tiranës, më 17 nëntor 1944. Divizioni sulmues, ky formacion i ri do të bënte të mundur unifikimin e detyrave dhe veprimeve, përqendrimin e tyre dhe të forcave në më pak hallka kyçe drejtuese, si dhe ndërmjetësimin me Komandën e Përgjithshme, duke shkurtuar largësinë në kohë ndërmjet tyre. Kjo hallkë, ky formacion i ri, në nivel ku kishte arritur Lufta dhe Ushtria NÇ., ishte plotësisht i mundshëm të krijohej. Prania e tij ishte sa e domosdoshme aq edhe e ndjeshme dhe e afërt.



Luftimet e ndryshme të Div. të I-rë pas formimit të tij(Etapa I)



Luftimet e ndryshme të Div. të I-rë pas formimit të tij(Etapa II)

GOLGOTA SHQIPTARE...

"Një vepër hyjnore humanizmi që mban në krahë vetë llahtarën"

Leo Freundlich, ishte autori me origjinë hebraike, me banim në Vjenë, që protestoi kundër zhdukjes masive të shqiptarëve nga serbët në vitet 1912-1913, zhdukje e cila kishte natyrën e Holokaustit. Libri i Freundlich, "Gologota shqiptare" ("Albanienes Golgotha") është dëshmi rrëqethëse për shfarosjen kolektive të një populli evropian, qysh më parë se ajo që do të ndodhte më vonë ndaj atij hebre. Mbi 250 mijë shqiptarë që u masakruan vetëm në veriun etnik të Shqipërisë gjatë vjeshtës së vitit 1912, janë veç gjysma e shifrës prej 500 mijë shqiptarësh të shfarosur nga masakrat serbe. Freundlich, është një ndër intelektualët e pakët që mbajti koleksionin e të gjitha gazetave të mëdha të kohës që tregonin mbi shfarosjen e së paku një gjysmë milioni shqiptarëve nga serbët në vitet 1912-1913. I revoltuar ai ngriti zërin e tij kundër asaj që ai e quajti "Golgotha Shqiptare", e që u shoqërua nga masakra të atij tipi që nuk i kishte njohur bota më parë. Leo Freundlich përshkruan në librin e tij kronikat e gazetave europiane për krimet e forcave serbe ndaj shqiptarëve.

"Më 12 nëntor të 1912-s, gazeta "Daily Chronicle" raportonte se masakrimi i mijëra shqiptarëve, i kryer nga serbët, ishte fakt i pamohueshëm. Afër Shkupit, u masakruan 2000 shqiptarë myslimanë dhe 5000 të tjerë, jo shumë larg Prizrenit. Shumë fshatrave u ishte vënë flaka dhe banorët e tyre ishin masakruar. Kur shtëpitë kontrolloheshin për armë, shqiptarët vriteshin në mënyrën më të thjesht, edhe pse nuk gjendej kurrfarë arme në shtëpitë e tyre. Serbët e bënë të qartë se shqiptarët myslimanë duheshin zhdukur e çrrënjosur. Ata pohonin se kjo është mënyra më efektive për ta qetësuar vendin…"

Në një artikull të publikuar në "Crusading", profesor Schiemann, konstaton se "serbët janë duke bërë një luftë gjenocidi kundër shqiptarëve. Ata duan që ta shfarosin tërë kombin - me rrënjë dhe degë". Një mjek rumun, dr. Leonte, më 6 janar 1913 raportonte në "Adeverul" të Bukureshtit se "mizoritë të cilat i kishte bërë armata serbe mbi shqiptarët, e të cilat i kishte parë vetë, kishin qenë shumë më të trishtueshme sesa mund t'i imagjinojë ndonjë njeri." Dr. Leonte në një përshkrim të dëbimit të qindra shqiptarëve të zënë rob, shkruan:

"…këta njerëz të shkretë duke ecur rrugëve, rrëzoheshin për tokë nga rraskapitja, uria dhe etja, kurse ushtarët serbë në ato çaste ua ngulnin bajonetat në fyt, duke e çuar gjakun curril dhe duke lënë rrugëve përplot kufoma të tyre të pavarrosura. Edhe fushat, ishin mbuluar me kufoma trupash të vrarë, përfshirë të rinj, gra apo edhe fëmijë. Një vajzë shqiptare 15 vjeçare - shkruan dr. Leonte – ishte rrëmbyer dhe ishte dërguar në Kështjellën e Nishit. Dyshohej se ajo kishte hedhur bomba kundër serbëve, të cilët kishin hyrë në Ferizaj. E gjora vajzë e vogël, e cila ngarkohej me këtë krim, iu dorëzua ushtarëve serbë, në vend që të dërgohej në gjyqin ushtarak. Ushtarët e goditën në kafkë me dajak derisa ia thyen kokën grimca-grimca!"

Dr. Leonte, në mënyrë të ngjashme me këto përshkruan edhe masakrat e bëra nga serbët, në Kumanovë, Prizren e gjetiu.

Gazeta "Humanite", e Parisit, publikoi një shpjegim zyrtar i cili ishte komunikuar në Konsullatën e Selanikut, ku tregon lidhur me mënyrën se si serbët kishin vepruar në Shqipëri - për grabitjet e tyre, shkatërrimet dhe masakrat. Aty vihet në pah shkatërrimi i 31 lokaliteteve shqiptare, plaçkitja e të gjitha lokaliteteve në rajonin e Kratovës dhe Koçanit si dhe djegia e vrasja e popullatës shqiptare. Në këtë kronikë, gazeta shkruan se "në rajonin e Kavadarcit (Kavadar), nga gjithsej 98 fshatra, u dogjën dhe u shkatërruan 34 prej tyre… ndërkaq në Drenovë, të gjithë banorët ishin vrarë. Midis këtij vendi dhe Palikurës ishin zbuluar me radhë, shumë varreza, ku prej disave dukeshin kokat e mbetura jashtë. Të fundit ishin varret e martirëve, të cilët ishin varrosur për së gjalli." (Leo Freundlich, Albanienes Golgotha, Wien, 1913).

"Publicisti Leo Freundlich, botoi veprën e famshme "Golgota shqiptare" – një vepër hyjnore humanizmi që mban në krahë vetë llahtarën…" – do të shkruante Riza Lahi, përkthyesi në shqip i "Golgota shqiptare" (Tiranë, Lilo, 1995), njëkohësisht edhe ish-gazetari i dikurshëm i revistës "Mbrojtja", i ndarë nga jeta pak kohë më parë. Leo Freundlich, nuk mund të parashikonte se kjo llahtarë do të ripërsëritej thuajse një shekull më pas… Këtë herë mekanizmi frenues ndërkombëtar, arriti të dallonte se peshorja e drejtësisë anonte, ashtu si edhe më parë, nga ana e shqiptarëve. Kjo drejtësi, sot e ka emrin: Shteti i pavarur i Kosovës…

A.Hitoaliaj

NJOFTIM

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Ministrisë së Mbrojtjes i është ofruar pjesëmarrja në kurse institucionale dhe funksionale në Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Qendrën Marshall, sipas periudhave të cilësuara në listën bashkëlidhur ANEKS A "Lista e kurseve të ofruara nëpërmjet programit CETPM/IMET", për vitin fiskal 2014. Drejtoria e Arsimimit dhe Përkujdesjes Sociale të Ushtarakëve ka vijuar praktikën për kërkim kandidaturash nga strukturat e FARSH. Me qëllim që ky njoftim të jetë sa më gjithë përfshirës është publikuar në faqen zyrtare të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura lista e kurseve dhe dokumenteve që kërkohen për aplikim për këto kurse.

Lista e kurseve të ofruara nëpërmjet programit CETPM/IMET", për vitin fiskal 2014. **ANEKS A**

Nr.	Periudha	Titulli I Kursit	Kuotat	Kriteret	Pershkrimi I Kursit	Afati
1	26 Shtator 2014 -15 Dhjetor 2014	Programi i Studimeve të Aplikuara të Sigurisë/ Program in Applied Security Studies (PASS)	**1 kuote**	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada →Toger – Major / Civil ekuivalent	Përshkrimi: Programi siguron edukim të nivelit të lartë në çështjet e politikës së sigurisë, të mbrojtjes, marrëdhënieve ndërkombëtare, ligjit ndërkombëtar, luftës kundër krimit, korrupsionit dhe trafikimit njerëzor dhe të drogës.	Jo me vone se 25 Prill 2014
2	16-Korrik-08-Gusht-2014	Aspektet ligjore të mbështetjes me burime të mbrojtjes në rastet e emergjencave civile	**1 kuote**	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada → e pa përcaktuar; Të tjera → rekomandohet që personeli i propozuar për ndjekjen e këtij kursi të kryej detyra në shtab, planifikim, këshilltar ligjor ose detyra komanduese	Përshkrimi: Ky kurs tre javor promovon mbështetjen e autoriteteve civile nëpërmjet burimeve të mbrojtjes në përputhje me parimet demokratike të rregullave dhe ligjeve në fuqi, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe përdorimi i forcës në mënyrë të arsyeshme. Kursi do të prezantojë mekanizmat ndërkombëtar ligjorë për dhënien e ndihmës humanitare në mënyrën më të mirë të pranueshme dhe në kohën e duhur, për ato vende të cilat janë goditur nga fatkeqësia natyrore. Qëllimi i kursit është të promovojë përdorimin e burimeve të mbrojtjes me përgjegjësi dhe efikasitet, në mbështetje të forcave të policisë dhe autoriteteve të menaxhimit të emergjencave civile, si dhe të rrisë kapacitetet e vendeve partnere për planifikimin dhe marrjen e asistencës së nevojshme në rastet e një fatkeqësie natyrore, nga Shtetet e Bashkuara dhe nga vendet e tjera donatore.	Jo me vone se 22 Maj 2014
3	30-Gusht-12-Shtator-2014	Veprimet Civilo-Ushtarake në luftën kundër terrorizmit	**1 kuote**	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada → Major-Kolonel / Civil ekuivalent	Qëllimi i këtij kursi është që të mbështesë këndvështrimin ndërkombëtar të komponentëve politik dhe ushtarak në luftën ndërkombëtare kundër terrorizmit, si dhe të rrisë kapacitetet e partnerëve të koalicionit për zhvillimin e programeve afat-shkurtra dhe afat-gjata për të luftuar terroizmin. Programe të qëndrueshme dhe në përputhje me principet demokratike. Ky kurs ofron një panoramë të plotë të të gjitha formave të terrorizmit me një theks të vecantë në formulimin e strategjisë dhe bashkëpunimit ndërkombëtar.	Jo me vone se 22 Maj 2014
4	01-Shtator 21-Nentor-2014	Kursi I shtabeve te bashkuara.	**1 kuote**	Niveli i gjuhës → anglisht 80 pikë; Grada → Major-Kolonel; Të tjera → të kenë përfunduar "Kursin e komandës dhe shtabit të përgjithshëm ose kurse të tjera ekuivalente jashtë vendit; pjesëmarrësit duhet të zotërojnë mirë gjuhën angleze dhe të jenë të jenë të aftë për të mbajtur prezantime mbi misionin, kapacitetet dhe eksperiencën e tyre në Forcat e Armatosura;	Kursi siguron studimin mbi strukturat e bashkuara dhe të ndërthurura, planëzimin dhe operacionet, aspektet që lidhen me sigurinë kombëtare e ndërkombëtare me qëllim përgatitjen e pjesëmarrësve për të shërbyer në komanda të bashkuara. Në veçanti tematika do të përmbajë parimet dhe konceptin themelor të strukturës së komandës së unifikuar të SHBA, organizimin, përbërjen dhe funksionet e një komande të bashkuar, planëzimi në nivel operacional, procesi i vendim marrjes ushtarake etj.	Jo me vone se 22 Maj 2014

D-Day, 70 vjet nga zbarkimi në Normandi

IMAGINE IF YOUR JOB DESCRIPTION SAID "SAVE THE WORLD."

Courtesy National Archives

Për të gjithë botën, 6 qershori 1944, do të mbetet në kujtesë si dita e zbarkimit të forcave aleate të koalicionit antifashist në plazhin e Normandisë. Trupat amerikane, britanike dhe kanadeze me zbarkimin e tyre në Francë ndërruan rrjedhën e LIIB dhe të fatit të Europës e të botës. Gjenerali Eisenhower nuk u kujdes që të fliste me delikatesë në momentin që foli para ushtarëve amerikanë, teksa ata po përgatiteshin për zbarkim. "Ky operacion është planifikuar si fitore dhe në këtë mënyrë ka për të përfunduar"- tha ai. Kaq e thjeshtë ishte. Në fakt, nuk ishte kështu. Trupat amerikane ishin të përbëra nga civilë dhe jo nga ushtarë të ushtruar në fushëbetejë. Beteja ishte e tmerrshme dhe shumë e përgjakshme. Sidoqoftë, SHBA dhe aleatët do të arrinin të zmbrapsnin nazistët dhe të çlironin Europën. Në muzeun kombëtar të D-Day mund të shihen akoma edhe sot uniformat e atyre burrave guximtarë, të cilët menduan se të shkonin në luftë ishte një detyrë e tyre, e cila duhej bërë. Në këtë foto që gjendet në muzeun kombëtar të D-Day, në New Orleans, shkruhet në mënyrë shumë kuptimplotë: "Imagjinoni sikur përshkrimi i vendit tuaj të punës të thoshte: Shpëto botën". Në fakt, ata e bënë punën e tyre... e shpëtuan.

D-DAY
THE NATIONAL D-DAY MUSEUM NEW ORLEANS